



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 10 regjistër (JR)  
Datë 02.03.2021

Nr. 28 i vendimit  
Datë 11.07.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 11.07.2023, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 303, datë 05.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1 germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për ngritjen dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet dhe

pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, të paraqitura në ankim dhe në parashtrime, e cila kërkoi marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit, gjykimin e çështjes në seancë publike riçeljen e hetimit gjyqësor, dhe përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 303, datë 05.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani (në vijim “subjekti i rivlerësimit” ose “subjekti”), me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet. Për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, me shortin e hedhur nga Komisioni më datë 12.11.2019.
2. Bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Prokuroria e Përgjithshme.

2.1 ILDKPKI-ja<sup>1</sup>, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, referuar deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit *vetting*, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar, duke konstatuar se: (1) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin*; (2) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë*; (3) *ka mosdeklarime ndër vite të pasurisë*; (4) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; dhe (5) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2 DSIK-ja<sup>2</sup>, pas procedurës së kontrollit të kriterit të figurës, konstatoi *përshtatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme<sup>3</sup> ka analizuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, si dhe pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin objekt shqyrtimi, pasi kreu procesin e rivlerësimit për të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) vendosi të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, bazuar në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit: (1) *ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin*; (2) *ka mungesa burimesh financiare me të ardhura të ligjshme*

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI nr. {\*\*\*} prot., datë 06.03.2018, për subjektin e rivlerësimit.

<sup>2</sup> Raporti i DSIK-së (klasifikuar “sekret” dhe deklasifikuar plotësisht) me nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2020.

<sup>3</sup> Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme nr. {\*\*\*} prot., datë 14.09.2018, për subjektin e rivlerësimit.

për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet për shkak të një balance negative; (3) ka kryer fshehje të pasurisë; (4) është në kushtet e konfliktit të interesave, të cilat e vendosin subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **III. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit**

4. Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka paraqitur ankim kundër vendimit të Komisionit, duke kërkuar: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) riçeljen e pjesshme të hetimit gjyqësor dhe realizmin e aktit të ekspertimit kontabël për analizën financiare të viteve 2003-2016; (iii) ndryshimin e vendimit të Komisionit; dhe (iv) konfirmimin e saj në detyrë. Argumentet e subjektit, në mënyrë të përmbledhur janë si vijojnë.

#### **4.1. Në lidhje me procesin e rregullt ligjor**

- (i) Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme, e pavarur dhe e krijuar me ligj.
- (ii) Është cenuar parimi i zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor nëpërmjet një hetimi të plotë e të gjithanshëm.
- (iii) Është cenuar neni 6 i KEDNj-së, pasi vendimi i Komisionit nuk është i arsyetuar.
- (iv) Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë.

#### **4.2. Në lidhje me pasuritë**

##### **4.2.1. *Për apartamentin në Përmet***

Subjekti pranon se ka pasur mosdeklarime të disa pagesave të kësteve të këtij apartamenti, “për shkak të harresës nga bashkëshorti” i saj, dhe nga disa faktorë shëndetësorë, por nuk kanë pasur për qëllim fshehjen. Komisioni duhet të kishte marrë në konsideratë aktmarrëveshjen e datës 01.05.2011, sipas së cilës janë kryer pagesat e kësteve mes bashkëshortit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Vlera 1.600.000 lekë i kaloi shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK në vitin 2016 për shlyerjen e kësteve sipas kontratës së porosisë dhe aktmarrëveshjes. Vitet 2011 dhe 2015, kur janë kryer porositja dhe blerja e këtij apartamenti, nuk janë me balancë negative.

##### **4.2.2. *Për automjetin, tip BMW***

- (i) Vlera prej 1.000.000 lekësh, e pasqyruar në kontratën e shitjes, përbën vlerën reale të automjetit, dhe jo pagesën e bërë. Sipas subjektit, vëllai i personit të lidhur/bashkëshortit [z. B. P.], në cilësinë e shitësit, nuk dhuroi vlerën 500.000 lekë, siç u llogarit nga Komisioni, por zbriti këtë vlerë nga çmimi total.
- (ii) Vlera e zhdoganimit të automjetit, në masën 62.818 lekë, nuk është deklaruar për shkak harrese, duke qenë nën 100.000 lekë.

##### **4.2.3. *Për depozitat bankare në Raiffeisen Bank, në Tirana Bank dhe Alpha Bank***

- (i) Subjekti nuk është dakord me konkluzionin e Komisionit për depozitën në Bankën e Kursimeve [sot Raiffeisen Bank]. Të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e saj janë të ligjshme dhe përfshijnë të ardhurat nga puna ndër vite, nga viti 1995 – 2003, ndërsa e ka të pamundur të

depozitë dokumentacion për interesat e përfutur nga depozita në Bankën e Kursimeve dhe firmat piramidale, për shkak të kohës relativisht të gjatë që ka kaluar.

(ii) Depozitat në Tirana Bank dhe Alpha Bank, krijuar më 26.07.2013, kanë si burim pakësimin e depozitës në Raiffeisen Bank. Mosdeklarimi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013, ka ndodhur pasi u krijuan nga depozita ekzistuese. Në deklaratat periodike vjetore të viteve 2014 – 2016, ka deklaruar shtesat nga interesi i depozitës, kështu që nuk ka kryer fshehje.

#### 4.3. Në lidhje me konstatimet e tjera të Komisionit

##### *4.3.1. Për prokurën e përfaqësimit, datë 15.01.2008, për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK*

Subjekti pretendon se nuk ka qenë në dijeni të kësaj prokurore. Pagesa në shumën 500.000 lekë që ajo ka kryer në Raiffeisen Bank, për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, kundrejt “{\*\*\*}” ShPK, nuk përbën veprim juridik, por veprime bankare në depozitën e saj në Raiffeisen Bank, në formë huaje, me qëllim mbylljen e xhiros së shitjes së karburantit. Këto veprime nuk kanë qenë në zbatim të të drejtave që i jepte prokura, as në emër e për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Kjo vlerë i është kthyer *cash* nga shoqëria dhe është mbajtur në gjendje të tillë [*cash*] për nevoja të familjes.

##### *4.3.2. Për pagesat nga Prokuroria Përmet në llogari të “{\*\*\*}” ShPK, gjatë kohës që subjekti ishte drejtuese e kësaj prokurorie*

Nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit, pasi në procedurën e prokurimit publik, ofertues nuk është shoqëria në fjalë, por “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}”. “{\*\*\*}” ShPK ka ofruar vetëm shitjen e karburantit, sipas kontratës së shërbimit që kishte me ofertuesit.

##### *4.3.3. Për transaksionet e kryera nga bashkëshorti i subjektit në bankën OTP, për llogari të “{\*\*\*}” ShPK*

(i) Këto pagesa janë nga të ardhurat e “{\*\*\*}” ShPK nga shitja e karburantit.

(ii) Komisioni nuk ka vlerësuar deklaratën e “{\*\*\*}” ShPK, që provon marrëdhënien e shërbimit midis “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK.

(iii) Transaksionet me vlerë 4.030.000 lekë, të konstatuara nga Drejtoria e Pastrimit të Parave, të kryera nga bashkëshorti në OTP Bank, për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nuk janë shpenzime të familjes dhe nuk duhet të përfshihen në analizën e saj financiare.

##### *4.3.4. Për pagesën 200.000 lekë, kryer më datë 26.06.2007, nga llogaria e bashkëshortit në Tirana Bank, për shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK*

Ky transaksion lidhet me fitimin e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Vlera i është kthyer bashkëshortit të saj dorazi, siç referon deklarata e administratorit të kësaj shoqërie, dorëzuar me pyetësin nr. 3. Komisioni nuk e ka vlerësuar këtë deklaratë.

##### *4.3.5. Për shumat e paguara nga dy individë në llogari të personit të lidhur/bashkëshortit*

Huatë e dhëna këtyre dy individëve prej bashkëshortit të saj, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore të vitit përkatës, pasi ka pasur pritshmërinë që nuk do të ktheheshin. Si burim krijimi të këtyre shumave, janë të ardhurat e përfutura nga bashkëshorti nga emigracioni në Greqi dhe nga puna në Përmet. Kthimi i huave është deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse.

Meqenëse u kthyen nëpërmjet sistemit bankar, shumat respektive duhet të përfshihen në analizën financiare, si e ardhur e ligjshme, për vitet 2012 – 2013.

#### 4.3.6. *Për shpenzimet e kryera për ndërhyrjen kirurgjikale të së bijës*

Në vitin 2007 ka marrë hua shumën 41.650 USD nga dy individë, të afërm të bashkëshortit, respektivisht 25.000 USD dhe 20.000 USD. Ndër ta, z. K. Gj. (djali i dajës së bashkëshortit), është administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, ndërsa z. N. P., vëllai i personit të lidhur/bashkëshortit, ka qenë emigrant në Greqi dhe është administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Huaja është marrë dorazi për mbulimin e shpenzimeve të operacionit të vajzës, por për shkak se shpenzimet u mbuluan nga shoqëria e sigurimit të motrës (si birësuese e vajzës së subjektit) në USA, sipas subjektit, huaja iu kthye dorazi huadhënësve. Përfshirja e këtyre vlerave në analizën financiare, sipas subjektit, ka rritur fiktivisht shpenzimet e vitit 2007.

#### 4.3.7. *Për konstatimin e fshehjes së tri llogarive të bashkëshortit të subjektit në Tirana Bank*

Mosdeklarimi i tri llogarive bankare të bashkëshortit në Tirana Bank, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka ardhur jo për qëllim të fshehjes, por për faktin se nuk kanë pasur asnjë ndikim ekonomiko-financiar në të ardhurat e familjes së saj. Transaksionet janë kryer për llogari të personit juridik “{\*\*\*}” ShPK, janë të ardhura nga shitja e karburantit nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK. Sipas subjektit, karburanti ishte pronë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

#### 4.4. Parashtrimet e datës 23.06.2023

Më 23.06.2023, nëpërmjet adresës elektronike, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrimet me shkrim për çështjen objekt shqyrtimi, në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012. Pas verifikimit të pretendimeve dhe kërkesave në parashtrime, rezulton që subjekti i ka qëndruar ankimit dhe nuk ka ngritur pretendime të reja, te j çfarë ka kërkuar në ankim.

### IV. **Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

#### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

##### a) *Juridiksioni i Kolegjit*

5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Silvana Pani, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### b) *Legjitimimi i ankuesit*

6. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë

Komisionit, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të këtij të fundit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit në Kolegj*

7. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtimi, si rregull, kryhet në dhomën e këshillimit mbi bazë dokumentesh. Përjashtim bëjnë rastet kur trupi gjykues konstaton se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51<sup>4</sup> të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 303, datë 05.10.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.
8. Analiza për pranueshmërinë e akteve shkresore bashkëlidhur ankimit<sup>5</sup>, u krye në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar në harmoni me nenin 51, pika 1, shkronja “a” e të njëjtit ligj. Sipas këtyre parashikimeve, subjekti i rivlerësimit nuk mund të paraqesë në ankim fakte të reja apo të kërkojë prova të reja, përveçse kur provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose të kërkojë marrjen e këtyre provave gjatë shqyrtimit në Komision<sup>6</sup>. Së pari, nga kjo analizë, rezultoi që subjekti nuk është gjendur në kushte të pamundësisë për paraqitjen e tyre në procesin e hetimit administrativ. Për rrjedhojë, paraqitja e tyre në ankim u çmua jo në përputhje me parashikimin ligjor të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

8.1. Së dyti, trupi gjykues vëren se vendimi i gjykatës për *kujdestarinë e vajzës* përbën përmbushje të detyrimit për të paraqitur materialin në formën e kërkuar ligjore. Subjekti rezultoi ta ketë përmbushur këtë detyrim të formës – duke paraqitur aktin me vulë apostile, të përkthyer, noterizuar dhe legalizuar – pasi ka marrë vendimin e Komisionit. Sidoqoftë, në kushtet që nga vendimi objekt ankimi, rezultoi se Komisioni e ka pranuar si të vlefshëm këtë vendim dhe e ka marrë në konsideratë, nën dritën e rregullimeve të nenit 49, pika 6, germa “b” e ligjit nr. 84/2016<sup>7</sup>, pranimi i këtij akti në cilësinë e provës, u konsiderua i panevojshëm pasi përbën mbështetje të një

---

<sup>4</sup> Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi, është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...]”.

<sup>5</sup> Subjekti ka dërguar: (i) vendim gjykate për *kujdestarinë e vajzës*, i përkthyer në shqip, i noterizuar dhe i legalizuar me vulë apostile; (ii) vërtetim i “{\*\*\*}” ShPK, datë 17 nëntor 2020; (iii) amendament i kontratës së nënqirasë, datë 01.10.2010.

<sup>6</sup> “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

<sup>7</sup> “[6]. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimin [...]”.

fakti të pranuar e provuar gjatë hetimit, në kushtet që Komisioni e ka reflektuar në analizën financiare.

**8.2.** Akti tjetër i përcjellë me ankimin, një vërtetim që mban datën 17.11.2020, lëshuar nga administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, rezulton po ashtu i panevojshëm, nën dritën e rregullimeve të nenit 49, pika 6, germa “a”<sup>8</sup>. Subjekti ka depozituar një deklaratë me të njëjtën përmbajtje si ky vërtetim, nga i njëjti person juridik, gjatë hetimit administrativ, më datë 27.04.2020. Nga krahasimi mes këtij akti dhe atij pjesë e fashikullit, rezulton se ndryshimi konsiston vetëm në titullin e aktit – “Deklaratë” kundrejt “Vërtetim” – ndërsa përmbajtja dhe nënshkruesi janë të njëjtë. Nga përmbajtja e vendimit, sikurse edhe e rezultateve të hetimit, evidentohet që subjektit i është kërkuar të provojë pretendimin se shumat e derdhura nga personi i lidhur/bashkëshorti në llogari të “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2015, janë gjeneruar nga shitja e karburantit prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Komisioni ka kërkuar fatura tatimore që do të provonin blerjen e karburantit, apo mandatpagesa që vërtetojnë likuidimin e këtyre faturave në shumat e mësipërme, në total në vlerën 4.030.000 lekë, nga njëra shoqëri te tjetra. Subjekti ka sjellë një deklaratë të administratorit të “{\*\*\*}” ShPK dhe dy (2) marrëveshje shërbimi të hartuara përkatësisht më 1 nëntor 2005 dhe 1 nëntor 2007<sup>9</sup>. Nga arsyetimi i Komisionit, deduktohet që këtyre akteve nuk u është dhënë vlerë provuese. Si rrjedhojë, në kushtet që akti i sjellë me ankimin, është në thelb i njëjtë me një deklaratë që është pjesë e fashikullit, trupi gjykues i Kolegjit e çmon marrjen e këtij akti të panevojshme. Dokumenti nuk paraqet asnjë situatë të re, të ndryshme nga deklarata e datës 27.04.2020, të aftë që të ndryshojë rezultatin e vendimit e, për pasojë, nuk mund të argumentohet se përbën provë të re, edhe duke abstraguar nga kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.

**8.3.** Së fundmi, amendamenti i kontratës së nënqirasë, lidhur në datën 03.09.2013, midis shoqërive “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, rezulton të jetë depozituar në ankim për herë të parë. Subjekti nuk ka shpjeguar apo pretenduar shkaqe që e penguan ta depozitonte këtë akt gjatë hetimit administrativ në Komision. Duke abstraguar nga fakti që këto akte nuk kapërcejnë kriteret ndaluese të provave të reja në ankim, përcaktuar nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012, referuar gjerësisht më sipër, si dhe probleme të qenësishme të formës<sup>10</sup>, ky akt gjithsesi rezulton i panevojshëm dhe nuk ndikon në zgjidhjen përfundimtare, parashikuar në rrethanat që nuk lejojnë marrjen e tyre sipas nenit 49, pika 6, gjerat “a” dhe “d”<sup>11</sup> të ligjit nr. 84/2016. Nëpërmjet pasqyrimin të faktit që “{\*\*\*}” ShPK është pronar i tokës në të cilën shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ushtron aktivitetin, subjekti synon të provojë lidhjen mes këtyre dy personave juridikë. Nga ana tjetër, ky akt nuk provon fakte të reja apo rrethana që do të saktësonin shkaqet për të cilat personi i lidhur/bashkëshorti ka kryer tri transaksione bankare në vitin 2015, në favor të këtij personi juridik [“{\*\*\*}” ShPK], apo burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e tyre.

**8.4** Për sa më lart, në zbatim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe të nenit 49, pika 6, gjerat “a”, “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerësoi të mos i pranojë aktet e sjella së bashku me

---

<sup>8</sup> Supra: “[...] ‘a) marrja e provës duket se është e panevojshme [...]”.

<sup>9</sup> Siç referon Komisioni në faqen 21 të rezultateve të hetimit administrativ dhe në faqen 32 të vendimit.

<sup>10</sup> Akti daton në vitin 2013 dhe është dorëzuar nga subjekti si fotokopje, e panjësuar me origjinalin, duke mos përmbushur kërkesat për të provuar autenticitetin e tij.

<sup>11</sup> Supra. Germa “d” parashikon: “[...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”.

ankimin në cilësinë e provës. Po ashtu, në kushtet që të dhënat që rezultojnë nga përmbajtja e këtyre akteve, nuk konsistojnë në fakte të reja, të panjohura më parë nga Komisioni, apo të cilat mund të kenë ndikim në vendimmarrjen e Kolegjit, u çmua e pabazuar dhe e panevojshme marrja e tyre në cilësinë e provave të reja në gjykimin në Kolegj. Analiza e themelit të shkaqeve të ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurisë, përmban aspektet e tjera të vlerësimit të trupit gjykues të Kolegjit lidhur me këto akte.

9. *Kërkesa për riçelje të pjesshme të hetimit dhe kryerja e aktit të ekspertimit kontabël për periudhën 2003 - 2016*

9.1. Komisioni ka kryer hetimin për të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit. Për kriterin e pasurisë, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka bërë deklarime të pasakta e të pamjaftueshme sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e ka zbatuar masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për dy kriteret e tjera, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka rezultuar e përshtatshme dhe *e pranueshme* për vazhdimin e detyrës. Ndër të tjera, Komisioni ka konstatuar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe përballuar shpenzimet, për një vlerë të konsiderueshme, prej (-) 11.592.775 lekësh. Subjekti ka kërkuar një ekspertim të ri kontabël, duke mos qenë dakord me analizën e kryer

9.2. Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pabazuar edhe këtë kërkim të subjektit. Në kushtet që nëpërmjet rezultateve të hetimit, subjektit i është bërë e ditur analiza financiare, tabela e detajuar e shpenzimeve si dhe çdo referencë/provë e përdorur nga Komisioni, riçelja e hetimit gjyqësor nuk konsiderohet e bazuar, për cilindo prej shkaqeve të parashikuara nga pika 1 e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012 [cituar në poshtëshënimin nr. 4 më sipër], parë nga këndvështrimi i përcaktimit të rrethanave faktike apo nga ai me natyrë procedurale. Nga kontrolli që Kolegji i ka bërë vendimit të Komisionit, nuk rezulton nevoja për marrje të provave të reja. Komisioni ka marrë provat në respektim të procedurës, dhe nuk rezultoi që gjendja faktike të mos jetë konstatuar drejt. Përpos këtij vlerësimi, arsyetuar në detaj në vijim, trupi gjykues çmon të theksojë faktin që nëpërmjet parashikimeve në nenet 22 dhe 23 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji dhe Komisioni, në veprimtarinë e tyre mbështeten në ndihmesën dhe këshillimin me njësitë përkatëse të shërbimit ligjor që asistojnë në vlerësimin pasuror nëpërmjet ekspertizës së tyre profesionale<sup>12</sup>.

9.3. Për sa më sipër, rezultoi e pabazuar kërkesa e subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, për një ekspertizë të re kontabël, në këtë fazë të procesit; subjektit i janë dhënë të gjitha mundësitë për të paraqitur aktet në mbështetje të pretendimeve të saj përgjatë hetimit administrativ, apo nëpërmjet shqyrtimit të ankimit të saj nga Kolegji. Në të njëjtën linjë, në kushtet që nuk u gjetën shkelje procedurale dhe subjekti nuk ka argumente për pamundësinë e saj për të paraqitur provat në hetimin administrativ, trupi gjykues e vlerëson të panevojshëm shqyrtimin e ankimit në seancë gjyqësore publike për të administruar prova të reja. Për rrjedhojë, pasi trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision,

---

<sup>12</sup> Sipas nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, është detyrë e këshilltarëve ekonomikë të Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj e në Komision: “[...] a) studimi i dosjes nga pikëpamja financiare/ekonomike dhe përgatitja e relacionit të çështjes, veçanërisht për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit; b) kryerja e detyrave të tjera të caktuara nga relatori i çështjes [...]”.



vendosi të shqyrtojë ankimin mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi, sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

10. Subjekti ka pretenduar se Komisioni ka cenuar parimin e gjykimit nga *një gjykatë e paanshme, e pavarur dhe e krijuar me ligj*, pasi e njëjta trupë gjykuese nuk mund të çmojë provat dhe më pas të japë vendim. Po kështu, hetimi dhe dhënia e vendimit nga i njëjti trup gjykues, e bën Komisionin organ akuzator dhe gjykatë, e cenon këtë parim, referuar vendimit të GjEDNj-së në çështjen *Belilos* kundër Zvicrës.

10.1. Pikësëpari, trupi gjykues vëren se nga aktet, nuk rezulton të jetë konstatuar apo argumentuar nga subjekti ndonjë pretendim specifik për mungesë paanshësie nga trupa gjykuese e Komisionit. Si rrjedhojë, mund të deduktohet qartë që ky pretendim është në nivel teorik – që lidhet me dispozitat kushtetuese e ligjore mbi të cilat vepron Komisioni – dhe jo derivat sjelljesh apo veprimesh konkrete. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit për cenim të këtyre parimeve themelore të procesit të rregullt, meqenëse hetimi kryesisht, çmuarja e provave dhe dhënia e vendimit janë kryer nga e njëjta trupë gjykuese është argument tashmë i ezauruar dhe i gjetur i pabazuar nga jurisprudenca e GjEDNj-së dhe bërë pjesë integrale e jurisprudencës së Kolegjit<sup>13</sup>.

10.2. Gjykata Kushtetuese<sup>14</sup>, Komisioni i Venecias nëpërmjet opinionit të hartuar për këtë qëllim, si dhe praktika e GjEDNj-së kanë konstatuar që organet e rivlerësimit ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për zhvillim të një procesi të rregullt ligjor<sup>15</sup>. Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, në çështjen kyç *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë, në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, gjykata ka analizuar se njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari, nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar, dhe argumentoi se:

*[...] nuk ka asnjë ngatërresë mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane [...]*<sup>16</sup>.

11. Subjekti, po ashtu ka pretenduar se parimi i procesit të rregullt ligjor është cenuar pasi *nuk* janë vlerësuar dhe pranuar të gjitha *dokumentet*, prapësimet e shpjegimet e subjektit. Subjekti pretendon po ashtu, edhe që Komisioni duhet të kishte marrë parasysh aktmarrëveshjen e datës 01.05.2011<sup>17</sup>. Këto pretendime u referohen në tërësi një sërë parashikimeve kushtetuese e ligjore, sikurse edhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, tri vendimeve të Gjykatës Kushtetuese,

<sup>13</sup> Shih, ndër të tjera, vendimin e Kolegjit (JR) nr. 8/2021 dhe (JR) nr. 32/2022.

<sup>14</sup> Shih paragrafin 44 të vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese.

<sup>15</sup> [https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/03/Vendimi\\_Alбина\\_Spaha\\_anonimizuar\\_per\\_web.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/03/Vendimi_Alбина_Spaha_anonimizuar_per_web.pdf) (parag. 20.2)

<sup>16</sup> Paragrafët 142 – 163 të Udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) – [https://www.echr.coe.int/Documents/Guide\\_Art\\_6\\_SOI.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SOI.pdf).

<sup>17</sup> Sipas kësaj marrëveshjeje me shoqërinë ndërtuese të apartamentit, subjekti kërkon të argumentojë pagesa këstesh të ndryshme nga sa ka rezultuar nga kontrata dhe aktet e tjera të kohës. Analizuar gjerësisht në vijim në shkaqet e ankimit që lidhen me themelin e vlerësimit të kriterit të pasurisë.

përkatësisht nr. 79/2017, nr. 36/2016 dhe nr. 49/2016, si dhe disa dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (neneve 10, 11, 14, 16, 19 dhe 213).

11.1. Në vendimin objekt ankimi, pasi ka analizuar aktmarrëveshjen në fjalë, Komisioni ka konkluduar se sa referohet në përmbajtje të saj, nuk ka gjetur materializim në asnjë prej deklarimeve periodike vjetore apo në deklaratën *vetting*, sikurse as në kontratën e shitjes së apartamentit të datës 31.12.2015. Për rrjedhojë, Komisioni konkludoi që përcaktimet në aktmarrëveshje nuk mund të konkurrojnë me kontratën e shitjes dhe pagesat që janë kryer në rrugë bankare, sipas parashikimit në kontratën e shitjes.

11.2. Ndërsa pretendimi i subjektit për mënyrën se si Komisioni ka analizuar këtë akt, është trajtuar gjerësisht në vijim, si pjesë e analizës së shkaqeve të ankimit për sa i përket vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të pakuptimtë e të pabazuar pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor, bazuar vetëm në mënyrën dhe peshën që Komisioni u ka dhënë provave të ndryshme. Nën dritën e parashikimit të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016<sup>18</sup>, vlerësimi i përcaktimeve kontraktore, deklarimeve periodike e atyre në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe akteve të tjera të kohës, është në thelb vendimmarrje e Komisionit bazuar në dokumente të njohura, të besueshme dhe në pajtueshmëri me provat e tjera. Ky vlerësim rezulton të jetë në përputhje me kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dispozitat e Kodit Civil për peshën që kanë përcaktimet kontraktore, vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore, ndër të tjera<sup>19</sup>. Pasi e ka marrë në shqyrtim aktmarrëveshjen, Komisioni nuk i ka dhënë peshë përkundër akteve të tjera. Për rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i subjektit për cenim të procesit të rregullt në kushtet që ai bazohet mbi faktin që Komisioni ka vlerësuar se prova të caktuara nuk janë të besueshme apo nuk arrijnë të zhbëjnë sa provohet nga akte të tjera.

12. Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, po ashtu ka parashtruar edhe pretendime të tjera që kontestojnë strukturën, thellësinë e arsytimit të vendimit të Komisionit, apo bazueshmërinë e tij në nenin D të Kushtetutës, si cenime të nenit 6 të KEDNj-së. Konkretisht, ajo pretendon se vendimi është *i paarsyetuar, me mungesë përfundimesh logjike*, në shkelje të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, *i njëanshëm*, në kundërshtim me normat procedurale dhe zbatim i gabuar i së drejtës materiale. Sipas subjektit, neni D i Aneksit të Kushtetutës, përcakton se: “nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën”. Po ashtu, argumenton ajo: “qartësisht konstatohet se subjektet e rivlerësimit që të jenë në kushtet e fshehjes apo deklarimit të rremë, duhet të kapen në mosdeklarim apo deklarim të pasaktë me qëllim përfitimin dhe shmangien nga kriteri i nenit të sipërcituar”.

12.1. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi që këto pretendime të ngritura nga subjekti për arsytimin e vendimit të Komisionit, janë të pabazuara, përpos që të përgjithshme dhe të pambështetura në fakte e rrethana konkrete, të cilat do të ilustronin ndonjë nga aspektet e pretenduara. Në këtë konkluzion, trupi gjykues ka mbajtur në konsideratë së pari, që subjekti parashtron në mënyrë të

---

<sup>18</sup> “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.”

<sup>19</sup> Neni D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, neni 690 i Kodit Civil dhe neni 32, pika 5 e ligjit nr. 9049/2003.

përgjithshme probleme e kundërshtime të vendimit, pa i specifikuar, fakt që mund të nënkuptojë që në thelb, është zgjidhja përfundimtare ajo që kontestohet e jo arsyetimi në vetvete. Së dyti, edhe nga analiza e kryer në Kolegj, në nivel teorik, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi i Komisionit përmbush përcaktimet formale të nenit 57 të ligjit nr. 84/2016. Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese, me gjithë përbërësit e tyre. Pasi ka parashtruar rrethanat e faktit, Komisioni ka analizuar provat dhe dispozitat ligjore të zbatueshme, duke përmbushur kështu kërkesat e diktuar nga kjo dispozitë. Vendimi objekt shqyrtimi përmban analizën e akteve të paraqitura nga subjekti përgjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, përfundimet e arritura në këtë vendim paraqiten si vijim i argumenteve të dhëna në pjesën arsyetuese, të cilat janë në kohezion me njëra-tjetrën, duke dhënë një panoramë të qartë të çështjes dhe zgjidhjes së dhënë nga Komisioni.

12.2. Pasi ka shqyrtuar provat dhe faktet, Komisioni ka evidentuar se subjekti i rivlerësimit për apartamentin e banimit në Përmet: (i) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurisë; dhe (ii) nuk arriti të provojë me dokumentacion burimin e ligjshëm për huatë dhe burimet e tjera të deklaruara dhe, si pasojë, gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë e të pamjaftueshëm, parashikuar nga germa “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Kjo situatë ka përbërë bazën mbi të cilën është vendosur marrja e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji. Nga ana tjetër, deklarimi i më shumë se dyfishit të pasurisë së ligjshme, është vetëm një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

12.3. Sikurse është zbrërthyer gjerësisht në vendime të tjera të Kolegjit, normat kushtetuese e ligjore të cilat parashikojnë situatat që passjellin masën disiplinore të shkarkimit, përcaktimet e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, janë autonome. Në varësi të rrethanave konkrete, secila prej tyre mund të passjellë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, parë në kuptim të deklaramit të pamjaftueshëm sipas nenit 61 të po këtij ligji. Ky i fundit, në pesë situatat ligjore të tij, nënkupton që subjektet e rivlerësimit duhet të shpjegojnë bindshëm se nuk gjenden në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, nuk kanë kontakte të papërshtatshme, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të vlerësimit të pasurisë, nuk kanë kryer deklarim të pamjaftueshëm të kontrollit të figurës, janë të aftë profesionalisht, dhe që me sjelljet dhe veprimet e tyre nuk kanë cenuar besimin e publikut të drejtësia.

12.4. Nga sa më sipër, është e qartë që pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se: *subjektet duhet të jenë në kushtet e fshehjes ose deklarimit të rremë/pasaktësi me qëllim përfitimin*, është i pakuptimtë pasi jo vetëm parashtron interpretime të pambështetura në gjuhën apo frymën e ligjit, por tenton të sjellë një interpretim i cili anashkalon me vullnet ekzistencën e një sërë parashikimeve ligjore të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, duke u fokusuar vetëm te dy prej tyre. Subjekti shton një kontekst të panjohur në këtë ligj, siç është “qëllimi i përfitimit”, e parashtron zbatimin e së njëjtës dispozitë si proces kumulativ e jo duke i parë situatat autonome. Situata e deklarimit të rremë është e ndryshme nga deklarimi i pasaktë në ligj, autonome, e jo domosdoshmërisht ato kushtëzohen nga njëra-tjetra në ligj. Atyre u referohen edhe germa të ndryshme, përkatësisht “a” dhe “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në legjislacionin që rregullon procesin e rivlerësimit, nuk ka asnjë parashikim i cili vendos si parakusht që fshehja apo deklarimi i rremë/pasaktë duhet të konstatohet vetëm si pasojë e një konkluzioni që ato janë kryer me “qëllim përfitimi”. Edhe në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e

pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), deklarimi i rremë, sipas nenit 38<sup>20</sup>, përbën vepër penale. As ajo dispozitë nuk e kushtëzon zbatimin e konceptit në fjalë nga qëllimi, cilido qoftë ai.

12.5. Nga ana tjetër, në procesin e rivlerësimit, situata e deklarimit të rremë apo e fshehjes së pasurisë përbëjnë shkak më vete për shkarkim nga detyra. Subjekti i rivlerësimit është shkarkuar si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme, deklarimit të pasaktë<sup>21</sup> dhe fshehjes së pasurisë, shkaqe ligjore të cilat nuk kushtëzohen me qëllimin e përfitimit. Për rrjedhojë, vendimi i Komisionit plotëson standardet e arsytimit nën dritën e garancive për proces të rregullt ligjor. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, se mosgjendja e saj në kushtet e deklarimit të dyfishit të pasurisë së ligjshme, dhe që konstatimi i fshehjes së pasurisë duhet të kushtëzohet nga konkluzioni i kryerjes me qëllimin e përfitimit, janë të pabazuara.

13. Subjekti ka pretenduar se është shkelur parimi i prezumimit të pafajësisë, meqenëse nuk janë marrë në konsideratë raportet e organeve ndihmëse për figurën dhe për anën profesionale. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

13.1. Së pari, në nivel parimor, prezumimi i pafajësisë nuk gjen zbatim në një procedurë me natyrë administrative sikurse është procesi i rivlerësimit. Përpos faktit që asnjë nga kriteret e shtjelluara nga GjEDNj-ja në çështjen *Engel* e të tjerë kundër Holandës<sup>22</sup> për të konkluduar se një procedim ka natyrë penale, nuk gjen zbatim në procesin e rivlerësimit, edhe dispozitat e Aneksit të Kushtetutës përjashtojnë shprehimisht huazimin e parimeve të procedimit penal në këtë proces. Konkretisht, nenet D, Dh dhe E të Aneksit shprehimisht parashikojnë prezumimin e masës disiplinore derisa subjekti nuk provon të kundërtën për secilin nga rastet specifike. Edhe vetëm ky fakt, parë së bashku me nenin Ç, pika 5 e Aneksit për barrën e provës, qartësisht përjashtojnë konceptet e parimet e procedimit penal në procesin e rivlerësimit.

13.2. Së dyti, në kushtet që ligji parashikon që vendimmarrja mund të kryhet edhe mbi bazën e një kriteri, referuar nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016<sup>23</sup>, vendimmarrja e Komisionit, bazuar në kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin, nuk mund të argumentohet edhe teorikisht se duhet të kushtëzohej nga raportet e organeve ndihmëse që fokusohen në dy kriteret e tjera.

13.3. Së treti, në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin 5 të ligjit nr. 84/2016, në mënyrë eksplicite është parashikuar që institucionet e rivlerësimit janë Komisioni dhe Kolegji. Në referim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, rikonfirmuar edhe në vijim në të njëjtën frymë nga GjEDNj-ja në çështjen *Xhoxhaj* kundër Shqipërisë<sup>24</sup>, organet e tjera të përfshira në procesin e

---

<sup>20</sup> Deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato, janë dokumente zyrtare. Paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën vepër penale dhe dënohet sipas legjisllacionit në fuqi.

<sup>21</sup> Shih vendimin e Kolegjit (JR) nr. 9/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit Nure Dreni.

<sup>22</sup> <https://hudoc.echr.coe.int/tur?i=001-57479>.

<sup>23</sup> “[ 2.] Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...]”

<sup>24</sup> “[...] Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (KPK-ja dhe KA-ja) të krijuara për këtë qëllim në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme. [...]”

rivlerësimi, kanë funksione ndihmëse dhe instrumentale me qëllim që të ndihmojnë institucionet e rivlerësimit në përmbushjen e mandatit të tyre. Ushtrimi i funksioneve nga organet e rivlerësimit nuk kufizohet në përfundimet e paraqitura nga organet ndihmëse. Këto institucione kryejnë kontroll dhe vlerësim të mirëfilltë të të gjithë dokumentacionit, si dhe kanë kompetencën vendimmarrëse. Përpos këtyre premisave ligjore, në kontekstin konkret, trupi gjykues i Kolegjit vëren se organi ndihmës në kontrollin e kriterit të vlerësimit të pasurisë [ILDKPKI-ja], ndër të tjera, ka konstatuar se deklarimi i subjektit *nuk* ka qenë i saktë, ka *mungesë* dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasurinë, ka *mosdeklarim* ndër vite të pasurisë.

13.4. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i pabazuar pretendimi i subjektit që konteston vendimin e Komisionit për masën disiplinore të shkarkimit për shkak të problemeve të konstatuara në kontrollin e pasurisë, bazuar në raportet pozitive të organeve ndihmëse për dy kriteret e tjera, atë të figurës e atë të vlerësimit profesional. Është po ashtu i pakuptimtë argumentimi i subjektit në drejtim të zbatimit të parimeve të procedimit penal në procesin e rivlerësimit. Pretendimi se është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë, për shkak se konkluzionet e *organeve të inteligjencës* nuk janë marrë parasysh, nuk gjendet i mbështetur.

14. Në përmbledhje të sa më sipër, për pretendimet e subjektit të rivlerësimit me natyrë procedurale, duke pasur parasysh edhe zërthimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor, referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së, mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve, për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve në proces, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt ligjor, nuk qëndrojnë dhe rezultojnë të pambështetura në ligj dhe në aktet në fashikull.

#### C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

15. Komisioni ka analizuar disa aspekte të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin, bazuar në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin, sikurse edhe gjetje të tjera. Përfundimisht, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta, ka mungesë burimesh financiare me të ardhura të ligjshme për të justifikuar pasuritë me një balancë negative prej (-) 11.592.775 lekësh, për gjithë periudhën e rivlerësimit, ka kryer fshehje të pasurisë dhe është në kushtet e konfliktit të interesit. Për të gjitha këto konkluzione, Komisioni ka vendosur që subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë, parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, nenin 61, pika 3 dhe nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se vendimi i Komisionit është i drejtë. Subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, përballimin e shpenzimeve të kryera, pasaktësisë së deklarimeve, konfliktit të interesit dhe fshehjes së pasurive, sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Arsyetimi i trupit gjykues shtjellohet në vijim.
16. *Apartamenti i banimit me vendndodhje në Përmet, me sipërfaqe 74,7 m<sup>2</sup>*

16.1. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti ka kryer deklarime të pasakta në deklaratat periodike dhe nuk justifikoi blerjen e kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme, sipas përcaktimeve në gerrat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat janë shkaqe për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Ky

konkluzion ka qenë pasojë e konstatimit të mospërputhjes midis çmimit të përcaktuar në kontratën e porosisë, datë 07.04.2011 – 30.000 euro dhe atij në kontratën e shitjes, datë 31.12.2015 – 27.000 euro. Gjithashtu, sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta për mënyrën e shlyerjes së kësteve dhe për pagesat e çmimit të apartamentit. Për pagesën e vlerës së apartamentit, Komisioni iu referua kontratës së shitjes së datës 31.12.2015, lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën ishte parashikuar se në momentin e nënshkrimit, vlera 27.000 euro ishte shlyer totalisht. Sipas analizës financiare në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare për të blerë apartamentin me të ardhura të ligjshme, pasi në vitet 2011 dhe 2015 rezultoi me balancë negative. Komisioni ka konstatuar se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme në vlerën (-) 4.931.850 për këto dy vite. Në këtë vlerë, Komisioni nuk rezultoi të ketë përfshirë apo të ketë marrë në konsideratë peshën e një transaksioni prej 1.600.000 lekësh nëpërmjet bankës, kryer në shkurt 2016, ndonëse ka arsyetuar se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse.

**16.2.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, kundërshton konkluzionin e referuar më sipër të Komisionit. Ajo pranon se “*ka pasur mosdeklarime*” të disa pagesave të kësteve në deklaratimet periodike vjetore për shkak të harresës së bashkëshortit, por jo me qëllim fshehjen. Shlyerjet e kësteve janë bërë si rezultat i aktmarrëveshjes së datës 01.05.2011, lidhur midis bashkëshortit dhe “{\*\*\*}” ShPK; vlera 1.600.000 lekë, kaluar në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK më 12.02.2016, përbën shlyerje të kësteve të apartamentit sipas kontratës së porosisë dhe aktmarrëveshjes së datës 01.05.2011. “{\*\*\*}” ShPK ka kredituar vlera të caktuara sipas kësaj aktmarrëveshjeje, sipas subjektit; transaksionet nuk kanë burim të ardhurat e subjektit, por janë një hua/kredi<sup>25</sup> e marrë prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Sipas analizës së dorëzuar prej saj dhe pretendimeve në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, parashtron se ka balancë pozitive në vitet 2011 dhe 2015.

**16.3.** Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për mungesë burimesh për krijimin e kësaj pasurie dhe pasaktësi në deklarime, është i drejtë, pavarësisht ndonjë kontradikte në linjën e arsyetimit. Në zbatim të garancive procedurale në gjykimin gjatë shqyrtimit të ankimit, trupi gjykues e kreu kontrollin e analizës financiare të Komisionit duke mbajtur në konsideratë dhe përlllogaritur vetëm vlerën e blerjes së pasurisë shkak ankimi. Pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit sipas shkaqeve të ankimit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar në germën "b" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në vijim shtjellohet analiza mbi të cilën u bazua ky konkluzion.

**16.4.** Nga aktet në fashikull rezultoi sa vijon:

a. Subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë blerë këtë apartament me *sipërfaqe 74,7 m<sup>2</sup>*, nga “{\*\*\*}” ShPK. Kontrata është lidhur në datën 31.12.2015, ndërsa regjistrimi është bërë në datën 23.01.2016. Në aktet në fashikull gjendet edhe një kontratë porosie mes palëve, me datë 07.04.2011<sup>26</sup>. Sipas kontratës së porosisë, çmimi është përcaktuar 30.000 euro, ndërsa në atë të shitjes 27.000 euro.

b. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, e ka deklaruar këtë pasuri me vlerë 27.000 euro, dhe me burim të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit. Të njëjtin

<sup>25</sup> Në aktmarrëveshje, palët janë cilësuar si “kredimarrës – A. P.” dhe “kredidhënës “{\*\*\*}” ShPK”.

<sup>26</sup> Kontrata e shitjes me nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2015, sipas akteve dërguar ILDKPKI-së nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP).

deklarim subjekti ka bërë edhe në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2015. Në kontratën e kalimit të pronësisë së kësaj pasurie, datë 31.12.2015, është shënuar se vlera 27.000 euro është likuiduar dhe palët nuk kanë pretendime.

c. Më 12.02.2016, pasi apartamenti edhe ishte regjistruar, përveçse shitur, bashkëshorti i subjektit ka kaluar vlerën 1.600.000 lekë në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me përshkrimin: “*Silvana Pani P. – Detyrim i debitorit A. P. për apartamentin e ndërtuar*”. Pyetur për këtë transaksion gjatë hetimit administrativ, më datë 27.05.2020 dhe datë 23.06.2020<sup>27</sup>, subjekti është përgjigjur se kontrata e shitjes është nënshkruar në dhjetor 2015, me kërkesë të ndërtuesit pasi, duke filluar nga viti 2016, tatimi mbi fitimin e biznesit të madh rritej nga 10% në 15%. Subjekti po ashtu ka pretenduar se bashkëshorti ka paguar këstet dorazi, me të ardhurat e pagave të tyre ndër vite, ndërsa vlera 1.600.000 lekë përbënte kthim këstesh “të kredituara” nga firma e ndërtimit para vitit 2015 “për efekt të dorëzimit të situacioneve të punimeve të ndërtimit në organin tatimor”.

ç. Më 03.08.2020, në përgjigje të kërkesës me shkrim të Komisionit, “{\*\*\*}” ShPK ka konfirmuar që pagesat janë kryer sipas kontratës së shitjes. Në përgjigje të shkresës së dytë të Komisionit, më 14.08.2020<sup>28</sup>, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka dërguar midis të tjerash, edhe një aktmarrëveshje që mban datën 01.05.2011, lidhur midis përfaqësueses së shoqërisë dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Objekti i kësaj aktmarrëveshjeje ishte *kreditimi* i blerësit (bashkëshorti i subjektit) deri në 40% të vlerës së apartamentit<sup>29</sup>.

d. Në përgjigjen me shkrim dërguar Komisionit, noteri pranë të cilit është nënshkruar kontrata e shitblerjes<sup>30</sup>, ka sqaruar Komisionin se kontrata e porosisë e datës 07.04.2011, është lidhur jashtë zyrës noteriale dhe është pjesë e dokumentacionit bashkëlidhur kontratës së shitblerjes. Nga ana tjetër, në kushtet që ndonëse kontrata e porosisë referohet si pjesë e dokumentacionit, kjo kontratë rezulton se nuk gjendet. Noteri nuk ka referuar po ashtu ekzistencën e aktmarrëveshjes së referuar më sipër [germa “ç” më sipër] në shkresën e dytë të shoqërisë së ndërtimit, nga e cila kërkohet të provohet një mënyrë e ndryshme pagesash.

16.5. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti kërkon të përfshijë në panoramën e rrethanave faktike, për herë të parë në hetimin administrativ, një aktmarrëveshje e cila tenton të zhbëjë detyrimet kontraktore të marra përsipër nga palët qoftë në kontratën e porosisë në vitin 2011, apo atë të shitjes në dhjetor 2015, e konfirmuar nëpërmjet regjistrimit të pasurisë në institucionet publike përkatëse. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen domethënëse po ashtu, të theksojë që kjo aktmarrëveshje, duke abstraguuar nga përcaktimet e pazakonta në të cilat i porosituri kryente edhe cilësinë e kreditorit, nuk është referuar as nga shoqëria ndërtuese në përgjigjen e saj të parë Komisionit. Përkundrazi, përfaqësuesja ligjore ka referuar që pagesat janë kryer sipas *kontratës së shitjes*. Nga

<sup>27</sup> *Sipas e-mail-eve pjesë e fashikullit krijuar në Komision.*

<sup>28</sup> *Nr. {\*\*\*} prot., datë 14.08.2020. Kësaj aktmarrëveshjeje, sipërmarrësi i ka bashkëlidhur nxjerrje llogarie, ku evidentohet kalimi i vlerës 1.600.000 lekë më 12.02.2016, edhe mandatarkëtime: mandat pagese {\*\*\*}, datë 02.05.2011 – shuma 5.000 euro (700.000 lekë) (kreditim AP sipas RF); mandat pagese {\*\*\*}, datë 26.07.2011 – shuma 300.000 lekë (kreditim AP); mandat pagese {\*\*\*}, datë 01.09.2011 – shuma 2.000 euro (280.000 lekë) (kreditim AP); mandat pagese {\*\*\*}, datë 30.12.2011 – shuma 1.500 euro (210.000 lekë) (kreditim AP).*

<sup>29</sup> *Sipas aktmarrëveshjes: “[...] E. M., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të “{\*\*\*}” ShPK, merr përsipër kreditimin e 40% të vlerës së kontratës, dt. 07.04.2011. Kreditimi do të përdoret për shlyerjen e detyrimit kontraktor të porosisë së apartamentit. Me përfundimin e procesit të regjistrimit të pronës në favor të porositësit, ky i fundit është i detyruar të shlyejë plotësisht kreditimin e bërë nga firma. Marrësi i kësaj kredie garanton shlyerjen nga depozita e bashkëshortes së tij, për pjesën e saj të bashkëpronësisë [...]”.*

<sup>30</sup> *Noteri M. L., përgjigjur nëpërmjet e-mail-it të datës 01.09.2020. Kontrata e shitjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.12.2015.*

ana tjetër, subjekti pohon një situatë sipas së cilës kushtet kontraktore kanë qenë formale pasi ndërkohë ajo dhe personi i lidhur kanë kryer veprime katërçipërisht të ndryshme “për efekt të dorëzimit të situacioneve të punimeve të ndërtimit në organin tatimor”. Ky pretendim i subjektit duket i paarsyeshëm dhe i pambështetur në ligj. Nga legjislacioni tatimor, nuk ka parashikim që situacionet e ndërtimit dorëzohen në tatime.

**16.6.** Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktmarrëveshja më datë 01.05.2011, paraqitet si një përpjekje e subjektit për të rrëzuar fakte të konstatuara gjatë hetimit administrativ. Ky konkluzion përforcohet nga fakti që ky akt nuk rezulton të jetë pjesë e dokumentacionit shoqëruar të tjetërsimit të pasurisë, dërguar pranë noterit në momentin e kalimit të pronësisë, sikurse edhe nuk gjen mbështetje as në legjislacionin tatimor detyrimi për depozitim situacionesh. Rezulton po ashtu alogjik shpjegimi i subjektit, që shoqëria zgjedhi që nga arka e saj të kreditonte personin e lidhur/bashkëshortin me vlera monetare në momente të caktuara për të mundësuar shlyerjen e kësteve sipas kontratës së porosisë, në mënyrë që ai t’ia kthente paratë shoqërisë si këste pagese të apartamentit. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit për ta përllogaritur shumën 27.000 euro të shlyer brenda vitit 2015, ashtu sikurse është deklaruar prej subjektit në deklaratën periodike vjetore të këtij viti.

**16.7.** Komisioni nuk e ka përllogaritur vlerën 1.600.000 lekë në çmimin e apartamentit, pavarësisht nga rrethanat faktike të konstatuara, që sugjerojnë pagesë që lidhet me pasurinë në kushtet që personi i lidhur kryen një pagesë ndaj një personi juridik me të cilin ka një marrëdhënie juridike porosie. Duke e lexuar në harmoni me kontratën e porosisë e atë të shitjes marrëveshjen e paraqitur rishtazi nga përfaqësuesja ligjore e të porositurit/ndërtuesit, prezantohet një marrëdhënie huaje, sipas së cilës ndërtuesi huadhënës bie dakord të kreditojë/japë hua deri në 40% të vlerës së kontratës së porosisë, në favor të porositësit/kredimarrësit. Thënë më thjesht, shoqëria zgjedh t’i japë të ardhura porositësit, që ai t’ia kthente përsëri shoqërisë. Në aktmarrëveshje, është cilësuar se shlyerja e detyrimit “do të vërtetohet nga noteri”, veprim që nuk rezulton të ketë ndodhur, ose minimalisht, subjekti nuk ka përcjellë dokumentacion në këtë drejtim.

**16.8.** Përpos këtij fakti dhe pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër për kundërthëniet që paraqet në vetvete kjo marrëveshje apo faktin që ka dalë për herë të parë vetëm në hetim, zgjidhja e një problemi mungese likuiditeti në këtë formë, duket e pakuptimtë. Në kushtet që ndërtuesi dhe porositësit përshkruajnë një marrëdhënie të karakterizuar nga mirëbesimi mes tyre, kreditimi i vlerës nga i pari tek i dyti në mënyrë që të rikthehej sërish te ndërtuesi e formalisht të konsiderohej pagesa e shlyer, duket veprim alogjik. Ndërtuesi kishte mundësinë të lejonte pagesën e vonuar të një pjese apo të gjithë vlerës së apartamentit, për t’iu përshtatur mundësive financiare të porositësit. Për këtë arsye, shpjegimi i subjektit për arsyet e kryerjes së një veprimi të ndërlikuar për të arritur një qëllim thjeshtësisht të realizueshëm në mënyrë të drejtpërdrejtë, duken jobindës. Ky fakt, së bashku me mungesën e akteve që do të provonin shpjegimet e subjektit dhe mungesën e deklaramit të detyrimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 e në vijim me statet e shlyerjes së tij, përkundër përcaktimeve kontraktore e sa ka rezultuar nga dokumentacioni, përforcon mungesën e besueshmërisë që data e vendosur në akt, pasqyron në fakt të vërtetën. Për rrjedhojë, transfertat e shumës 1.600.000 lekë, në shkurt 2016, nuk provohet të jetë kryer si pasojë e aktmarrëveshjes së analizuar. Në këto kushte, ky akt nuk mund të konsiderohet provë e besueshme e që vjen në



harmoni me provat e tjera dhe, si i tillë, nuk mund të merret në konsideratë, në kuptim të pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016<sup>31</sup>.

**16.9.** Balanca negative financiare për krijimin e kësaj pasurie dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera konkluduar nga Komisioni, u konfirmua edhe nga analiza e kryer në Kolegj. Subjekti rezultoi me pamundësi financiare për blerjen e pasurisë në çmimin 27.000 euro [ose 3.731.445 lekë], me të ardhura të ligjshme, pasi bilanci financiar për vitet 2011 dhe 2015 rezulton negativ. Palët kanë parashikuar një çmim dhe një kalendar të ndryshëm në kontratën e porosisë, i cili nuk gjen konfirmim në dokumentacionin bankar<sup>32</sup>. Për rrjedhojë, sikurse Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit e kreu analizën bazuar në mandatpagesat që shoqërojnë kontratën e shitjes, si dhe në çmimin e përcaktuar në kontratë e të përdorur në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, datë 31.12.2015, vlera e pasurisë është 27.000 euro. Në këtë kontratë, është shënuar se vlera është likuiduar totalisht dhe palët nuk kanë pretendime.

**16.10.** Nga analiza financiare e kryer mbi bazën e vlerësimit të referuar më sipër, sipas mandateve bankare që shoqërojnë dokumentacionin e dorëzuar pranë noterit<sup>33</sup>, rezultoi që personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka paguar 21.800 euro dhe 718.000 lekë, deri në fund të vitit 2015, në favor të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Këto pagesa dhe likuidimi i plotë i vlerës 27.000 euro në total, sipas kontratës së shitjes, janë konfirmuar edhe nga administratorja e “{\*\*\*}” ShPK, me shkresën e parë dërguar Komisionit më datë 03.08.2020. Nga ana tjetër, pagesa e vlerës 1.600.000 lekë në vitin 2016, edhe në analizën e kryer në Kolegj, u përfshi si shpenzim i vitit 2016 për apartamentin.

**16.11.** Sa më sipër, paraqet rëndësi në kushtet që ka mospërputhje mes sa rezulton nga mandatpagesat që shoqërojnë kontratën e shitjes përkundër çfarë kanë përcaktuar palët në kontratën e porosisë, si dhe çfarë ka deklaruar subjekti i rivlerësimit ndër vite në deklarata periodike vjetore, dhe përkundër shpjegimeve gjatë hetimit administrativ. Së fundmi, të gjitha këto shpjegime/përcaktime bien ndesh me shkresën e dytë të dërguar nga përfaqësuesja e shoqërisë së ndërtimit më 14.08.2020. Konkretisht:

- (i) në kontratën e shitjes dhe nga mandatpagesat, rezulton që subjekti ka paguar 19.500 euro dhe 500.000 lekë në vitin 2011, në vitin 2012 ka paguar 150.000 lekë, ndërsa në fund të vitit 2015 ka shlyer pagesën prej 2.300 eurosh dhe 68.000 lekësh;
- (ii) në deklaratimet periodike vjetore, subjekti nuk ka deklaruar *asnjë* pagesë në vitin 2011, dhe ka deklaruar një pagesë prej 10.000 eurosh dhe 200.000 lekësh në vitin 2015, e 1.600.000 lekë në vitin 2016;
- (iii) në shkresën e parë të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK [03.08.2020], pagesat e kryera në vitin 2011, përkojnë me kontratën e shitjes për të tria vitet;

---

<sup>31</sup> “[ 4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. [...]”

<sup>32</sup> Në këtë kontratë është caktuar çmimi 30.000 euro dhe shlyerja e kësteve si vijon: i) 10.000 euro, shlyer në momentin e lidhjes së saj; (ii) 5.000 euro brenda 30.05.2011; (iii) 10.000 euro brenda datës 30.12.2011; (iv) diferenca “[...] nëpërmjet rakordimit midis palëve, me dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë”.

<sup>33</sup> Konkretisht, nga mandatpagesat, rezultojnë të jenë paguar 19.500 euro + 500.000 lekë në vitin 2011, në vitin 2012 shuma prej 150.000 lekësh dhe në vitin 2015 është likuiduar shuma 2.300 euro + 68.000 lekë.

- (iv) në shkresën e dytë të së njëjtës përfaqësuese, 11 ditë më pas, deklarohet një situatë pagesash tërësisht e ndryshme. Konkretisht, shkresa referon pagesë të vlerës 9.500 euro në fund të vitit 2011, dhe 1.600.000 lekë në vitin 2016;
- (v) në përgjigje të pyetësorit nr. 2 [maj 2020], subjekti ka paraqitur një situatë tjetër, të ndryshme nga gjithë sa referuar, duke pretenduar pagesë prej 15.500 eurosh deri në fund të vitit 2015 dhe pjesa prej 1.600.000 lekësh, ekuivalenti i 11.600 eurove në vitin 2016;
- (vi) së fundmi, në përgjigje të rezultateve të hetimit, në datën 29.09.2020, subjekti ka deklaruar një kalendar pagesash tjetër/të ndryshëm nga ai i referuar në secilin nga momentet kohore të sipërpërmendura. Konkretisht, subjekti ka pretenduar se në fund të vitit 2011, në fakt ka paguar 10.000 euro dhe 200.000 lekë; në vitin 2012, në total 150.000 lekë; në vitin 2015, 2.300 euro dhe 68.000 lekë; e pjesa e mbetur prej 11.500 eurosh [ekuivalenti i 1.600.000 lekëve], është paguar në vitin 2016.

**16.12.** Mospërputhjet e pretendimet kontradiktore të përmbledhura më sipër, u vlerësuan si një aspekt integral i mungesës së besueshmërisë së shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, e si përpjekje e saj për të pasqyruar rrethanat nën një dritë të favorshme në rivlerësim. Përfundimisht, pasi kreu kontrollin e analizës financiare të Komisionit, bazuar në kalendarin e pagesave të përcaktuar në kontratën e shitjes dhe akteve në fashikull, edhe trupi gjykues i Kolegjit konkludoi se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, parashikuar në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për të gjithë vlerën e apartamentit që e konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të kohës, do të ishte (-) 3.731.445 lekë. Edhe nga analiza e kryer në Kolegj, subjekti rezultoi me balanca negative për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve për vitet 2012 dhe 2015. Për pasojë, konfirmohet minimalisht balanca negative e secilit prej këtyre viteve, konstatuar në Komision, njëkohësisht edhe pamundësia e shlyerjes së vlerës së apartamentit. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit që kanë për fokus të ndryshojnë analizën për pasuritë në vitin 2011, ndërsa për vitin 2015 kontestojnë kryesisht shpenzimet e përlllogaritura, u vlerësuan të pabazuara. Pjesërisht, zëra të caktuar të këtyre pretendimeve shtjellohen në vijim në shkaqet përkatëse të ankimit.

**16.13.** Nga ana tjetër, ndonëse është i saktë konstatimi i Komisionit për pasaktësi të demonstruara nga subjekti në mënyrë të vazhdueshme në deklaratat periodike/vjetore, trupi gjykues çmon të theksojë se në procesin e rivlerësimit, konstatimi i pasaktësisë në deklarime, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, lidhet me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [vetting]. Siç është arsyetuar më sipër, deklaratimet ndër vite të subjektit, të cilat përbëjnë provë në proces, u vlerësuan nga trupi gjykues si një aspekt i mungesës së besueshmërisë së situatës faktike e ligjore të subjektit në lidhje me këtë pasuri. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon pjesën e konkluzionit të Komisionit vetëm për sa i përket germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 për mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt analize.

## 17. Automjeti tip “BMW”

**17.1.** Komisioni ka konkluduar se subjekti (i) nuk ka deklaruar saktë në deklaratën vetting vlerën e automjetit pasi nuk ka përfshirë vlerën e zhdoganimit, si dhe nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie; (ii) nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie, pasi bilanci financiar ditën kur palët kanë nënshkruar kontratën e shitjes [02.11.2011], është negativ, në vlerën (-) 1.673.452 lekë; (iii) nuk ka provuar me dokumentacion mundësinë e vëllait

të bashkëshortit, B. P., për dhurimin e shumës 500.000 lekë. Për këto shkaqe, Komisioni ka konkluduar që subjekti ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

17.2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, kundërshton konkluzionin e Komisionit. Ajo pretendon se vlera 1.000.000 lekë, e pasqyruar në kontratën e shitjes, përbën vlerën reale të automjetit, dhe jo vlerën e pagesës. Subjekti pretendon se shuma 500.000 lekë, që përbën gjysmën e vlerës së automjetit, nuk përbën dhurim, por një vlerë të cilën shitësi/vëllai i bashkëshortit e ka zbritur nga vlera totale e automjetit. Ndërsa mosdeklarimi i vlerës së zhdoganimit prej 62.818 lekësh, është pasojë e harresës meqenëse flitej për një vlerë relativisht të ulët.

17.3. Nga verifikimi i akteve në fashikull përkundër shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka plotësuar saktë deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kushtet kur nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Në vijim, shtjellohet arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion.

17.4. Nga aktet në fashikull rezulton sa vijon.

a. Sipas kontratës së shitjes<sup>34</sup> së këtij automjeti, palët kanë përcaktuar si çmim 1.000.000 lekë, vlerë e “likuiduar jashtë zyrës noteriale”. Automjeti i importuar nga ShBA-ja është zhdoganuar në doganën Përmet, në shumën 62.818 lekë, nga bashkëshorti i subjektit/personi i lidhur. Më herët, me një prokurë të posaçme, bashkëshorti i subjektit ka fituar edhe të drejtën “ta blejë vetë mjetin”<sup>35</sup>.

b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011, përpos blerjes së këtij automjeti, subjekti ka deklaruar vlerën 1.000.000 lekë dhe si burim krijimi ka referuar 500.000 lekë *cash* dhe 500.000 lekë dhuratë nga z. B. P.. Nga ana tjetër, në atë deklaratë subjekti nuk ka deklaruar pakësim [apo shtim] të gjendjes së *cash*-it.

c. Në deklaratën *vetting*, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijim e kësaj pasurie.

17.5. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në Komision, subjekti është shprehur se në aktin e shitjes pasqyrohet vlera reale e tregut për automjetin, që ishte 1.000.000 lekë. Komisioni e ka cilësuar vëllanë e bashkëshortit të subjektit [z. B. P.] person tjetër të lidhur dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar mundësinë e dhurimit të vlerës 500.000 lekë prej tij. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti është shprehur që 500.000 lekë ishte vlera që bashkëshorti i detyrohej të vëllait dhe që nuk ka deklaruar se ishte shlyer menjëherë, por në vlera të vogla ndër vite kur shitësi/kunati i subjektit vinte në Shqipëri. Subjekti ka sjellë akte për të provuar të ardhurat e ligjshme të vëllait të bashkëshortit në ShBA në vitet 2002-2003 dhe 2008-2009, në kontekst të huave të dhëna prej tij përkatësisht në vlerën 5.000 USD dhe 30.000 USD në vitet 2009 dhe 2010. Nga pretendimet në ankim, duket se subjekti kërkon që për vitin 2011 të përllogarit vetëm vlera e paguar për zhdoganimin.

17.6. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren që është i bazuar konstatimi i Komisionit për pasaktësi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për shkak të mungesës së deklaramit të

<sup>34</sup> Nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol., datë 02.11.2011, mes palëve, bashkëshorti i subjektit/blerës dhe vëllai i tij, z. B. P./ shitës.

<sup>35</sup> Prokurë e datës 22.04.2010, me nr. rep. {\*\*\*} dhe {\*\*\*} kol., lëshuar nga B. P. për A. P..

burimeve të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie. Kjo pasaktësi vjen në kundërshtim me germën “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Është po ashtu i bazuar edhe konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Edhe në analizën e kryer në Kolegj në funksion të këtij shkaku ankimi, konfirmohet balanca negative e përllogaritur nga Komisioni. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se vlera e paguar është sa gjysma e asaj për të cilën palët kanë rënë dakord në kontratë, mbeti deklarative. Në kushtet që palët kishin mundësi të pasqyronin ekzakhtësisht të gjitha detajet me rëndësi, përfshirë çmimin e rënë dakord, detyrimet e mbetura pa shlyer apo “dhurimin” e gjysmës së çmimit nga shitësi, sikurse edhe veshur këtë vullnet me formën e kërkuar nga ligji, trupi gjykues i Kolegjit i gjen pretendimet e subjektit jobindëse.

17.7. Duke i vlerësuar shkaqet e ankimit dhe aktet në fashikull nën dritën e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në analizën e kryer në Kolegj u përllogarit vlera sipas kontratës së shitjes<sup>36</sup> që, në zbatim të dispozitave të Kodit Civil, ka forcën e ligjit. Pretendimi i subjektit që në fakt janë paguar vetëm 500.000 lekë, nënkupton që vlera e deklaruar në kontratë dhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit *vetting*, është e pavërtetë. Në kushtet që palët kanë deklaruar në kontratë se vlera 1.000.000 lekë është shlyer jashtë zyrës noteriale, është e drejtë analiza e kryer nga Komisioni në funksion të krijimit të kësaj pasurie, pasi mban në konsideratë vlerën provuese të kontratës, në kuptim të nenit 690<sup>37</sup> të Kodit Civil. Në kontroll të analizës së Komisionit, mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, dhe e bashkëshortit të saj për blerjen e automjetit, edhe në Kolegj, u realizua duke marrë në konsideratë vlerën e përcaktuar në kontratën e shitjes, që është 1.000.000 lekë së bashku me vlerën e zhdoganimit. Nga kontrolli, rezulton se subjekti gjendet në kushtet e pamundësisë financiare për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve deri më 02.11.2011, kur bleu automjetin.

17.8. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se cilësimi i vëllait të bashkëshortit si person tjetër i lidhur për këtë pasuri, është vlerësim i pabazuar. Së pari, në kushtet që Komisioni ka vlerësuar të gjithë çmimin sipas kontratës së shitjes, deduktohet që *dhurimi* i prezantuar nga subjekti, është përjashtuar si aspekt i qenësishëm në krijimin e kësaj pasurie. Nga ana tjetër, dhe duke abstraguuar nga ky konstatim, edhe nëse do të pranohej pretendimi i subjektit se është paguar vetëm gjysma e vlerës së referuar në kontratë, dhurimi i pretenduar nuk është i mirëfilltë pasi është materializuar nëpërmjet mosmarrjes së 500.000 lekëve e jo nëpërmjet transaksionit tipik të kalimit të të ardhurave. Me fjalë të tjera, pretendohet shitje në një vlerë që përbën gjysmën e asaj të specifikuar në kontratë, e jo dhurim i mirëfilltë. Vëllai i bashkëshortit, në cilindo version faktesh, nuk pretendohet të ketë tërhequr nga të ardhurat e tij shumën korresponduese të “dhurimit”. Në këtë kontekst, mundësia financiare e vëllait të bashkëshortit për të kontribuar duke mos përfituar 500.000 lekë, rezulton e panevojshme të analizohet në kuadër të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016<sup>38</sup>. Së dyti, në një variant tejet garantist të analizës, ku pranohet se kunati nuk e mori

---

<sup>36</sup>“[ 4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelit të bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

<sup>37</sup>“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. [...]”

<sup>38</sup>“[ 4.] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. [...]”

gjysmën e vlerës prej 500.000 lekësh nga shitja e automjetit, përsëri subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë.

**17.9.** Në përmbledhje të sa më sipër, nga verifikimi i akteve në fashikull dhe pas kontrollit të analizës së Komisionit sipas shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka plotësuar saktë deklaratën e pasurisë për rivlerësimin dhe gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, përcaktuar në germat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në analizën e kryer në Kolegj, pavarësisht disa korrigjimeve, minimalisht konfirmohet balanca negative e konstatuar nga Komisioni, dhe pasuria rezulton e pambuluar me burime të ligjshme.

## **18. Tri depozitat bankare**

**18.1.** Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar një depozitë në Alpha Bank dhe një në Tirana Bank, krijuar më 26.07.2013, nga pakësimi i një depozite në Raiffeisen Bank. Secila prej tyre ka një vlerë përreth 2,7 milionë lekë [e rumbullakosur]<sup>39</sup>. Burim krijimi i të ardhurave janë deklaruar të ardhurat e dy bashkëshortëve nga pagat, tërhequr nga depozita në Raiffeisen Bank, në vlerën 5 milionë lekë në datën e çeljes së dy depozitave të tjera – 26.07.2013. Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk arriti të kundërshtojë bindshëm barrën e provës dhe gjendet në kushtet e germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, meqenëse nuk justifikoi me të ardhura të ligjshme shtesat në depozitën në Raiffeisen Bank, si dhe mbulimin e shpenzimeve përgjatë periudhës 2003 – 2013. Në këtë konkluzion, Komisioni ka mbajtur në konsideratë balancat negative të rezultuara në vitet 2006, 2007, 2009, 2010 dhe 2011, si pasojë e të cilave shtesat e kryera në depozitën origjinare nuk mbulohej me burime të ligjshme. Komisioni ka konstatuar po ashtu edhe që subjekti nuk i ka deklaruar çeljet e këtyre depozitave në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013. Së fundmi, Komisioni ka konstatuar se analiza e paraqitur nga subjekti gjatë hetimit administrativ, nuk mund të merret në konsideratë pasi është e paplotë, ka gabime materiale dhe nuk pasqyron situatën reale financiare të subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, dhe të familjes së saj.

**18.2.** Në ankim, sikurse edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti parashtron se ka deklaruar saktë çdo vit ndryshimet në depozitën fillestare/origjinare. Përjashtim bën viti 2004, për të cilin nuk ka informacion nga banka. Subjekti po ashtu ka detajuar edhe shtesat e pakësimit për çdo vit. Si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, potencon pagat e saj dhe të bashkëshortit, sikurse edhe interesat e depozitës. Në tabelat e paraqitura si pjesë e shkaqeve të ankimit, parashtrohen përlllogaritje sipas të cilave shtesat e shpenzimet në vitet 2003-2016 mbulohej tërësisht nga të ardhura të ligjshme nga pagat dhe nga interesat bankarë.

**18.3.** Nga analiza e akteve në fashikull përkundër pretendimeve të subjektit në ankim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se vlerësimi i Komisionit është i bazuar. Edhe në analizën e kryer në Kolegj në funksion të kontrollit të vendimit objekt ankimi, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme shtesat në depozitën në Raiffeisen Bank, që është depozita origjinare e dy të tjerave. Për rrjedhojë, subjekti gjendet në kushtet e parashikuara në germën "b" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të balancave

---

<sup>39</sup> Përkatësisht, depozita në Alpha Bank, në vlerën 2.693.368 lekë, si dhe ajo në Tirana Bank, në vlerën 2.695.515 lekë.

negative mes të ardhurave e shpenzimeve në gjashtë (6) vite, e konkretisht 2006, 2007, 2009, 2010, 2011 dhe 2015. Përlllogaritja mbi të cilën konfirmohet balanca negative e konstatuar në Komision, shtjellohet në vijim si pjesë e analizës së vendimit të Komisionit lidhur me analizën financiare të kryer gjatë hetimit administrativ.

**18.4.** Nga aktet në fashikull, rezulton se subjekti ka deklaruar depozitë në Bankën e Kursimeve [tashmë Banka Raiffeisen] në vlerën 2.000.000 lekë, me burim “të ardhurat nga paga” në Raiffeisen Bank, e deklaruar në deklaratën e parë të vitit 2003. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, është shprehur se burim krijimi i depozitës kanë qenë pagat e saj për periudhën 1993-1995 e vazhdim, interesat e përvitshëm të akumuluar nga depozita dhe interesa nga firmat piramidale. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se nuk ka qenë e mundur të gjente informacion për vitin 2004, ndonëse e ka kërkuar. Edhe për të ardhurat nga firmat piramidale subjekti nuk ka sjellë informacion, duke specifikuar kohën që ka kaluar në periudhën e ndërmjetme. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të krijuar depozitën në vlerën 2.000.000 me burime të ligjshme deri në vitin 2003. Nga ana tjetër, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë shtesat e pakësimet e likuiditeteve në këtë depozitë për harkun kohor 2003-2013, nuk ka deklaruar tërheqjen e depozitës në vitin 2013 dhe ka qenë në pamundësi për të krijuar shtesat e likuiditeteve në vitet me balancë negative mes të ardhurave, pasurive të krijuara dhe shpenzimeve për pesë (5) vite.

**18.5.** Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, konstaton që subjekti ka deklaruar në mënyrë të pasaktë ndryshimet në depozitën në fjalë në harkun kohor 2003-2013, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003. Konkretisht, në disa vite, subjekti ka deklaruar shtesa më të larta sesa evidentohet nga dokumentacioni bankar, në disa të tjera shtesa më të ulëta, ndërsa për gjashtë (6) nga këto vite, nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për shtesat. Për vitin 2004, subjekti nuk ka deklaruar shtesë apo pakësim ndonëse nga aktet rezulton të ketë depozituar në *cash* një vlerë prej 400.000 lekësh. Së fundmi, në vitin 2013, subjekti nuk ka deklaruar mbylljen e depozitës në fjalë dhe ndarjen e fondeve në dy depozitat e tjera. Përpos mospërmbushjes së këtij detyrimi sipas ligjit, në kushtet që në fashikull gjendet dokumentacioni bankar për çdo vit pas vitit 2005, në analizën e kryer edhe në Kolegj, mosdeklarimi nuk përbën pengesë për kryerjen e kontrollit të analizës financiare.

**18.6.** Nga kontrolli i analizës së kryer në Kolegj, konfirmohet konkluzioni i Komisionit për mundësinë financiare të krijimit të depozitës origjinare në vlerën 2.000.000 lekë me të ardhurat deri në vitin 2003. Nga ana tjetër, rezulton që subjekti ka depozituar ndër vite në total vlerën 5.157.000 lekë, në harkun kohor 2004 – 04.07.2016, në depozitën origjinare dhe më pas në dy të tjerat, të krijuara si derivat i mbylljes së saj. Edhe në kontrollin e kryer në Kolegj, subjekti rezultoi me pamundësi financiare për shtesat me burime të ligjshme për vitet në të cilat përftohet një balancë negative mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Në këtë vlerësim, trupi gjykues çmon të theksojë se përrreth 74% e kësaj shtese [3.827.000 lekë] përbëhet nga transfertat direkt nga llogaria e pagës së patërhequr të subjektit, në depozita, ndërsa pjesa tjetër, janë depozitime në *cash* prej 930.000 lekësh, si dhe 400.000 lekë të pidentifikueshme. Me fjalë të tjera, subjekti nuk ka tërhequr apo përdorur pagën, duke krijuar kursim nëpërmjet shtesës së depozitës në periudhën në fjalë, sikurse edhe ka depozituar *cash* gjatë kësaj periudhe në llogarinë bankare.

**18.7.** Në kushtet që Komisioni nuk ka kryer analizë financiare për mundësinë financiare të kursimit të pagës – përkundër shpenzimeve – në momentin e depozitimit/transferimit të tyre, edhe

në kontrollin e kryer në Kolegj, u përdor e njëjta metodologji. Në këtë kontekst, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë që ndonëse të ardhurat nga pagat që kanë përbërë shtesa në depozita, janë në vetvete të ardhura të ligjshme, në parim depozitimi i tyre nënkupton kursim. Analiza e mundësisë së krijimit të kursimeve, në momentet kohore kur ato janë transferuar për të shtuar depozitën, do të krijonte një panoramë më të qartë rreth burimit të krijimit të depozitave. Komisioni rezultoi t'i ketë përlllogaritur këto aspekte vetëm si pjesë e analizës vjetore. Nga analiza e kryer, me të njëjtën metodologji me Komisionin, u konfirmuan edhe në Kolegj pesë (5) vitet me balancë negative të konstatuara nga Komisioni, në drejtim të analizës së këtyre depozitave, konkretisht vitet 2006, 2007, 2009, 2010 dhe 2011.

**18.8.** Në analizën e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, nuk përlllogariti dy vlera monetare të deklaruara të kthyer nga z. E. M. dhe z. G. Ll., personit të lidhur/bashkëshortit në vitet 2012 dhe 2013, përkatësisht 850.000 lekë dhe 3.496 USD. Ndërsa një vlerësim i detajuar i shkaqeve për të cilat ky pretendim i subjektit u vlerësua i pabazuar shtjellohet në vijim, në këtë pjesë të arsytimit ato referohen për shkak të lidhjes direkte dhe efektit mbi mundësinë e krijimit të depozitës origjinare përpara deklaratës së parë vjetore në vitin 2003. Konkretisht, nëse do të pranohej pretendimi i subjektit për ekzistencën e kësaj marrëdhënieje huaje të bashkëshortit në vitet 1995-2003, do të përmbysesh rezultati pozitiv për mundësinë e krijimit të vlerës prej 2.000.000 lekësh, depozituar në ish-Bankën e Kursimeve.

**18.9.** Në përmbledhje, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pamundësi për të krijuar me të ardhura të ligjshme shtesat në depozitën në Raiffeisen Bank, sikurse edhe ato të cilat përkojnë me shtesat në dy depozitat e krijuara në vitin 2013, në Alpha Bank dhe Tirana Bank, sipas parashikimit të germës “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Siç referohet më sipër, vlera konkrete e konstatuar në analizë për mungesën e burimeve për krijimin e këtyre pasurive, është pjesë integrale e analizës financiare tërësore të arsytuar në vijim në këtë vendim. Nga ana tjetër, referenca e Komisionit në *“deklarim jo vetëm të pasaktë, por edhe të përsëritur”*<sup>40</sup> vetëm për njërën nga dy depozitat e derivuara nga ajo fillestare – ndonëse në kushte identike ligjore e faktike me tjetrën – u çmua nga trupi gjykues i Kolegjit si një konstatim pa peshë specifike, duke pasur parasysh jo vetëm që Komisioni nuk ka referuar një dispozitë ligjore mbi të cilën bazohet ky vlerësim e mbi të gjitha, duke mbajtur parasysh që nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, objekt i procesit të rivlerësimit është saktësia e deklaramit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ndërsa deklarimet periodike vjetore janë prova në procesin e rivlerësimit.

#### **Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me gjetjet e tjera të Komisionit**

- 19.** Nën rubrikën “Gjetje të tjera”, Komisioni është ndalur në hetimin e kryer për disa fakte të rezultuara nga shpjegimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, si dhe nga sa ka rezultuar nga aktet e administruara në përgjigje të informacionit të kërkuar kryesisht. Në përfundim, Komisioni ka konstatuar që subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani: (i) ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës për sa i përket prokurimit për furnizim me naftë të institucionit të cilin ajo drejtonte – Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet – nga një person juridik [“{\*\*\*}” ShPK], pronar i të cilit është kunati i saj; (ii) ka kryer fshehje të pasurisë; dhe (iii) ka mungesë

<sup>40</sup> Faqe 25 e vendimit të Komisionit: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2020/11/Vendim-Silvana-Pani.pdf>.

burimesh të ligjshme për shpenzimet e kryera, në vlerën 11.592.775 lekë, në analizën financiare të kryer për vitet 2003-2016. Në analizën financiare të pasqyruar në vendimin e Komisionit<sup>41</sup>, rezultojnë me balancë negative gjashtë (6) vite. Komisioni ka konstatuar po ashtu një vazhde mosdeklarimi veprimesh nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, për shkak të të cilave ka vlerësuar të konsiderojë me peshë të barabartë këto deklarata me atë të pasurisë së rivlerësimit, për shkak të peshës së pasaktësive në deklaratimet e saj. Së fundmi, Komisioni ka vërejtur që një sërë transaksionesh të kryera prej vetë subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortit, sugjerojnë që bashkëshorti i subjektit ka krijuar të ardhura si *ortak i padeklaruar* i “{\*\*\*}” ShPK.

19.1. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka kundërshtuar këto konkluzione në tërësi. Pa përsëritur përmbledhjen e shkaqeve të ankimit, pasqyruar më sipër në vendim [shih paragrafin 4.3], subjekti konteston të gjitha aspektet e këtyre konkluzioneve të Komisionit, duke argumentuar se: (i) nuk qëndron konstatimi për ushtrim të detyrës në kushtet e konfliktit të interesave pasi ofertues në prokurim ishte një kompani e ndryshme nga ajo e kumatit të saj; (ii) prokura e përfaqësimit e vitit 2008, që autorizon atë vetë të kryejë veprime në emër të “{\*\*\*}” ShPK, është hartuar pa dijeninë e saj; (iii) një pagesë bankare prej 500.000 lekësh, e kryer prej saj në favor të një personi juridik që tregton karburante [“{\*\*\*}” ShPK në vitin 2011] nuk përbën veprim sipas prokurës, por një veprim të thjeshtë bankar; (iv) vlera 4.030.000 lekë e transferuar nga bashkëshorti në vitin 2015, nuk është shpenzim familjar, por është kryer për llogari të një subjekti tregtar karburantesh [“{\*\*\*}”] nga të ardhurat e “{\*\*\*}” ShPK nga shitja e karburantit; (v) pagesa prej 200.000 lekësh, kryer nga bashkëshorti në vitin 2007, ishte në ndihmë të një personi juridik [“{\*\*\*}” ShPK] dhe i është kthyer dorazi; (vi) llogaritë bankare në emër të bashkëshortit në Tirana Bank nuk janë deklaruar pasi nuk kanë pasur ndikim ekonomik. Transaksionet e kryera nëpërmjet tyre në vitin 2008, kanë qenë për llogari të personit juridik [“{\*\*\*}”] nga shitjet e karburantit të kryera nga personi juridik që kryente shitjet [“{\*\*\*}” ShPK].

19.2. Nga analiza e akteve në fashikull dhe fakteve që rezultojnë prej tyre, parë nën dritën e dispozitave kushtetuese e ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara dhe jobindëse. Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka vepruar në kushtet e konfliktit rast pas rasti të interesit në vendimmarrjet e saj, ka ndërthurur interesat e saj dhe vjelë përfitime materiale prej marrëdhënies së interesit me kumatin. Parë së bashku me transaksionet bankare të kryera nga bashkëshorti, pranuar edhe nga subjekti se janë për llogari të personit juridik në pronësi të kumatit, sikurse edhe prokurat e lëshuara në emër të subjektit dhe personit të lidhur/bashkëshortit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i bazuar konstatimi i Komisionit se bashkëshorti i subjektit është ortak i padeklaruar në këtë aktivitet. Trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti dhe personi i lidhur kanë fshehur interesat e tyre privatë në personin juridik në pronësi të kumatit të subjektit [shoqëria “{\*\*\*}” ShPK].

19.3. Në kushtet që të ardhurat familjare të subjektit dhe personit të lidhur rezultojnë të ndërthurura pazgjidhshmërisht me ato të gjeneruara nga aktiviteti privat i tregtimit të karburantit, trupi gjykues i Kolegjit vendosi t’ia ngarkojë shpenzimet ekonomisë familjare të subjektit të rivlerësimit, në analizën e viteve përkatëse, shtjelluar në vijim. Po ashtu, analiza financiare e përfutur nga Komisioni, u konfirmua në Kolegj pasi trupi gjykues i gjeti jobindëse pretendimet e subjektit për pagesën e bashkëshortit në favor të një personi juridik, shpjegimet lidhur me të

---

<sup>41</sup> Faqe 54 e vendimit.



ardhurat me burim kthimin e huave nga dy individë. Trupi gjykues po ashtu vlerësoi se subjekti nuk provoi burimet e ligjshme të huadhënësve që janë deklaruar si burim për transfertën bankare në ShBA për shpenzimet mjekësore të vajzës së subjektit, sikurse as pretendimet për të ardhura të fituara nga bashkëshorti nga lotaria. Analiza e trupit gjykues shtjellohet në vijim.

Ç/1. Marrëdhënia e subjektit dhe personit të lidhur me personin juridik “{\*\*\*}” ShPK

20. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka deklaruar dy prokura, nëpërmjet të cilave kunati i saj [vëllai i bashkëshortit, z. N. P.] autorizonte bashkëshortin e subjektit dhe vetë subjektin [sikurse edhe kunatin tjetër] për të vepruar në emër e për llogari të personit juridik “{\*\*\*}” ShPK<sup>42</sup>. Dy prokurat u përkasin viteve 2005 dhe 2008. Konkretisht, me prokurën e përgjithshme të përfaqësimit<sup>43</sup>, datë 01.11.2005, kunati i subjektit, në cilësinë e ortakut të shoqërisë, ka caktuar përfaqësues të përgjithshëm të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me tagra të pakufizuar, bashkëshortin e subjektit<sup>44</sup>. Më 15.01.2008, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me prokurën e posaçme<sup>45</sup>, i njëjti individ/kunati ka caktuar si përfaqësues subjektin e rivlerësimit dhe vëllanë tjetër të tij [z. A. P.], duke i autorizuar që të kryejnë veprime juridike në emër dhe për llogari të shoqërisë, me afat të pakufizuar. Në këtë prokurë, ndër të tjera, përcaktohej se përfaqësuesit – subjekti dhe kunati tjetër i saj – kishin të drejtë të merrnin pjesë edhe në tenderat publikë. Sipas një deklarate noteriale të vetë subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, që mban datën 11.02.2016, paraqitur prej saj së bashku me dy prokurat e mësipërme, prokura e posaçme që i jep asaj tagra përfaqësimi [më datë 15.01.2008] është kryer pa dijeninë e saj dhe ndërsa ishte jashtë Shqipërisë.

20.1. Nga hetimi që ka kryer Komisioni, ka rezultuar se në vitet 2006, 2007 dhe 2011, Prokuroria Përmet ka kryer prokurimin publik dhe në vijim është furnizuar me naftë nga “{\*\*\*}” ShPK. Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka mbajtur cilësinë e drejtueses së Prokurorisë në periudhat kohore mars 2004 – shtator 2007 dhe shkurt 2011 – mars 2016. Nga dokumentacioni i dërguar nga Prokuroria Përmet, rezulton se për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar dy urdhërpagesa për kreditorin “{\*\*\*}” ShPK, përkatësisht në mars e prill 2006. Të dyja faturat tatimore të shitjes janë nënshkruar nga kunati i subjektit për llogari të “{\*\*\*}” ShPK. Për vitin 2007, subjekti ka nënshkruar tri urdhërpagesa për kreditorin “{\*\*\*}” ShPK, përkatësisht në maj, qershor dhe korrik. Të tria faturat tatimore të shitjes janë nënshkruar nga kunati i saj, z. N. P.<sup>46</sup>. Së fundmi, në vitin 2011, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë, subjekti ka nxjerrë urdhër prokurimi, si pasojë e të cilit, Komisioni i Prokurimit ka përcaktuar si fitues “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK e “{\*\*\*}” ShPK. Fatura tatimore në emër të “{\*\*\*}” ShPK, e lëshuar disa ditë pas procedurës së prokurimit, më 29.11.2011, është nënshkruar sërish nga kunati i subjektit të rivlerësimit, z. N. P..

<sup>42</sup> Sipas ekstraktit të regjistrimit tregtar të QKB-së, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK është regjistruar në vitin 2005, dhe ka për objekt tregti karburantesh.

<sup>43</sup> Nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol.

<sup>44</sup> Në këtë prokurë, përfshihen tagra të cilësisë së ortakut [shtim/pakësim të aktivitetit të shoqërisë, hapje të filialeve] dhe të administratorit [të lidhë dhe nënshkruajë kontrata pune për punonjës, të përfaqësojë në çdo bankë, të hapë llogari bankare, të tërheqë dhe të hedhë shuma në bankë, të nënshkruajë çeqe, si dhe akte të tjera pa kufizim.

<sup>45</sup> Nr. {\*\*\*} rep., {\*\*\*} kol.

<sup>46</sup> Për të provuar, ndër të tjera, marrëdhënien mes “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK, subjekti ka sjellë një kontratë shërbimi, sipas së cilës “{\*\*\*}” ShPK vepronte si nënkontraktor i “{\*\*\*}” edhe për shitjen me pakicë të karburanteve. Kontrata mban datën 1 nëntor 2007, disa muaj pas faturave të shitjes nënshkruar nga kunati i saj.

**20.2.** Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjatë ushtrimit të funksionit të drejtueses së Prokurorisë, subjekti i rivlerësimit është gjendur në *kushtet e konfliktit rast pas rasti të interesit* në vendimmarrjet për procedurat e prokurimit të furnizimit me naftë nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në pronësi të kumatit të saj. Trupi gjykues vëren se në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, elaboruar edhe në jurisprudencën e Kolegjit<sup>47</sup>, kunati i subjektit është person tjetër i lidhur me të [subjektin e rivlerësimit]. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë veprimet financiare të kryera nga subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë Përmet, duke nënshkruar akte konkrete gjatë gjithë procedurës së prokurimit, përfshirë lidhjen e kontratës dhe transaksionet për kryerjen e pagesave në favor të shoqërisë në pronësi të kumatit të saj, parë nën dritën e nenit 3 [pika 4, germa “ç”] të ligjit nr. 9367/2005, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

**20.3.** Sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit i gjeti të pabazuara dhe jobindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, për arsyet për të cilat janë kryer veprimet e sipërcituara prej saj, qoftë sipas pretendimit për mungesë operatorësh të tjerë që mund të ofronin të njëjtin shërbim në të njëjtat kushte cilësore apo për faktin që kontrata ishte e lidhur me një subjekt tjetër tregtar, ndërkohë që gjithë faturat e marra në analizë janë lëshuar e autorizuar prej kumatit. Në kushtet që subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ishte e ndërjegjshme që ortakut i vetëm, themeluesi dhe administratori i kësaj shoqërie, është kunati i saj, sikurse edhe të faktit që minimalisht bashkëshorti kishte një prokurë me tagra gjithëpërfshirës, mosmarrja e masave të parashikuara nga ligji për shmangien e konfliktit, konsiderohet si situatë konflikti i interesit edhe në kuptim të pikës 1 të nenit 3<sup>48</sup> të ligjit nr. 9367/2005. Këtë konkluzion, trupi gjykues e pa të lidhur ngushtë me faktin që nga analiza tërësore e rrethanave faktike, marrëdhënia e subjektit me këtë aktivitet privat ka krijuar fitime materiale për të, siç është referuar më sipër e në vijim.

**20.4.** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni është informuar<sup>49</sup> për tri transaksione bankare të bashkëshortit të subjektit në Bankën OTP (ish-“Societe Generale”) mes 30 korrikut e 10 tetorit 2015, në shumën 4.030.000 lekë, më përshkrimet “derdhje *cash* në lekë”. Subjekti shpjegoi se pagesat janë për llogari të shitjes së karburantit nga “{\*\*\*}” ShPK, për llogari të një personi tjetër juridik dhe, në mbështetje të këtij pretendimi, paraqiti një marrëveshje shërbimi të lidhur më 1 nëntor 2007 mes dy shoqërive në fjalë [konkretisht “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK]. Komisioni përfundimisht ka konstatuar se aktet e sjella nga subjekti, përfshirë këtë aktmarrëveshje, sikurse edhe një tjetër të përcjellë pasi kishte nisur procesi i vendimmarrjes<sup>50</sup>, nuk provojnë që janë gjeneruar nga shitja e karburantit dhe vendosi t’ia ngarkojë ato analizës financiare të subjektit dhe personit të lidhur. Komisioni me atë rast ka vërejtur që nga aktet e sjella nga subjekti<sup>51</sup>, rezultojnë edhe depozita të tjera bankare të krijuara nga bashkëshorti i subjektit, në vlerën 3.066.000 lekë, në

---

<sup>47</sup> Shih, *ndër të tjerë, vendimin e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit D. Rreshka, § 107-109, në: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-Dritan-Rreshka-i-anonizuar-per-publikim.pdf>*

<sup>48</sup> “[1.] “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisive të tij publike. [...]”

<sup>49</sup> Sipas raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, datë 26.12.2019, në përgjigje të shkresës së Komisionit. Tri transaksionet janë në shumën si vijojnë: 1.500.000 lekë, 1.000.000 lekë dhe 1.530.000 lekë, respektivisht më 30 korrik, 15 shtator dhe 30 tetor 2015.

<sup>50</sup> Referuar në fund të faqes 33 të vendimit të Komisionit.

<sup>51</sup> Konfermë e llogarisë bankare të personit juridik tjetër [“{\*\*\*}” ShPK] nga Alpha Bank.

të njëjtën periudhë kohore [shtator-tetor 2015], të cilat nuk u përlllogaritën në analizë. Nëse do të përfshiheshin në analizën financiare, këto depozitime do të kishin efekt thellues të balancës negative për vitin 2015.

**20.5.** Nga hetimi administrativ, kanë rezultuar edhe tri llogari bankare të bashkëshortit të subjektit në Tirana Bank, në lekë, euro dhe dollarë amerikanë, të çelura dhe të mbyllura në harkun kohor 2007-2014. Këto llogari *nuk* janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore. Vlerësimi i thelluar i shkaqeve të ankimit për dy llogaritë në euro e dollarë vijon në rubrikën përkatëse në vijim. Për qëllime të trajtimit të çështjeve që rezultojnë nga analiza e marrëdhënies së subjektit me aktivitetin tregtar “{\*\*\*}” ShPK, trupi gjykues i Kolegjit në këtë pjesë të arsyetimit, u ndal në llogarinë *në lekë*, nga e cila rezultojnë të dhëna për transfertë bankare nga subjekti tregtar i karburanteve [“{\*\*\*}” ShPK] më 24.10.2006, drejt bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**20.6.** Komisioni konkludoi në vendim se asnjë nga pretendimet e subjektit nuk e justifikon mosdeklarimin e këtyre tri llogarive, përfshirë shtesat dhe pakësimet e tyre, për një periudhë 6-vjeçare, duke shkelur kështu detyrimin e parashikuar në nenet 3 dhe 4 të ligjit nr. 9049/2003. Sipas Komisionit, shkak i mosdeklarimit të këtyre tri llogarive bankare [që nga subjekti u prezantua fakti se nëpërmjet tyre janë kryer edhe veprime për likuidimin e detyrimeve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe më vonë “{\*\*\*}” ShPK] ngre dyshime për ortakëri të fshehur/të padeklaruar të bashkëshortit të subjektit në këtë aktivitet. Duke mbajtur në konsideratë numrin e konsiderueshëm të transaksioneve të kryera gjatë periudhës së rivlerësimit, mosdeklarimin e këtyre llogarive bankare, Komisioni çmoi ta konsiderojë jo thjesht një pasaktësi në deklarim, por edhe si fshehje pasurie, përcaktuar nga neni 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 .

**20.7.** Së fundmi, lidhur me marrëdhënien e subjektit dhe personit të lidhur me aktivitetin tregtar në pronësi të kumatit [“{\*\*\*}” ShPK], Komisioni ka konstatuar dhe kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, për pagesa në *cash* në bankë prej saj dhe personit të lidhur/bashkëshortit. Konkretisht, Komisioni ka administruar të dhëna nga dy banka [Tirana Bank dhe Raiffeisen] për katër (4) transfertat të kryera në favor të një subjekti tregtar karburantesh [“{\*\*\*}”/“{\*\*\*}” ShPK], respektivisht në qershor 2008 nga bashkëshorti i subjektit në shumën 838.713 lekë dhe në tetor 2011 nga vetë subjekti në shumën 500.000 lekë. Subjekti ka shpjeguar se të gjitha pagesat janë në funksion të likuidimit të detyrimeve ndaj subjektit tregtar të karburanteve për llogari të aktivitetit tregtar të kumatit të saj.

**20.8.** Në kushtet që subjekti nuk ka provuar këtë pretendim, pasi ka vërejtur që subjekti nuk dha shpjegime për barrën e provës për këtë gjetje, Komisioni e ka përlllogaritur gjithë vlerën [1.338.713 lekë] në ngarkim të subjektit dhe personit të lidhur në analizën financiare të secilit vit, ndonëse për transaksionet e tjera të referuara më sipër, ka mbajtur qëndrim të qartë e të shprehur për fshehje të interesave privatë të bashkëshortit në këtë aktivitet.

**20.9.** Në prapësim të këtyre aspekteve të vendimit të Komisionit, dhe kryesisht me fokus ndryshimin e balancës negative financiare të viteve përkatëse, subjekti ka argumentuar së pari, që depozitat në bankën OTP në vitin 2015 nga bashkëshorti, janë *të ardhura nga fitimi* i aktivitetit tregtar [shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK], nuk përbëjnë shpenzime të familjes së saj dhe nuk ka pasur për qëllim fshehjen e pasurisë. Sipas saj, ky fakt provohet nga deklarata e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, vlefshmëria e së cilës nuk është arsyetuar nga Komisioni, por është anashkaluar.

Në ankim subjekti bashkëlidhi një deklaratë të thjeshtë të administratorit të kësaj të fundit për të provuar këtë fakt. Së dyti, llogaritë në tri monedha në Tirana Bank, janë çelur vetëm për të bërë të mundur pajisjen me vizën amerikane, për të depozituar garancinë e vizës [arsyetuar veçmas në vijim], si dhe për të likuiduar detyrime të aktivitetit tregtar në pronë të kunatit [shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK], shkak për të cilin nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

**20.10.** Për sa u përket veprimeve bankare të kryera prej saj për llogari të aktivitetit privat të kunatit, subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka argumentuar kryesisht në funksion të kontestimit të prokurës së posaçme të vitit 2008, që autorizonte vetë atë për të kryer veprime në emër të subjektit tregtar në pronësi të kunatit. Në këtë drejtim, subjekti ka argumentuar se transaksioni bankar nuk përbën veprim juridik që do të vlerësonte e konfirmonte prokurën. Siç është arsyetuar edhe më sipër, subjekti ka pretenduar se prokura e posaçme është lëshuar pa dijeninë e saj.

**20.11.** Ndërsa aspekti i analizës financiare trajtohet në vijim, nga analiza harmonike e akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, përpos sa është argumentuar më sipër për gjendjen e subjektit në konflikt rast pas rasti të interesit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se marrëdhënia e ndërthurur, e vazhdueshme dhe me përfitime materiale mes personit të lidhur/bashkëshortit dhe vetë subjektit me personin juridik, pronë e kunatit të saj, është tregues i interesave privatë të *fshehur* në aktivitetin në fjalë. Të gjitha veprimet e evidentuara më sipër, të rezultuara qoftë nga aktet e administruara gjatë hetimit, sikurse edhe nga vetë shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, dëshmojnë për një përfshirje aktive të bashkëshortit të subjektit dhe subjektit në aspekte të ndryshme të aktivitetit tregtar të shoqërisë, me vijimësi në kohë. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, ky angazhim dhe tagrat e dhënë nga pronari *de jure* personit të lidhur/bashkëshortit dhe vetë subjektit, për t’u kujdesur e menaxhuar aspekte të përgjithshme sikurse edhe të veçanta të aktivitetit të shoqërisë, nuk mund të përkojnë përveçse me interesa thelbësorë si ata që shoqërojnë një ortak.

**20.12.** Pretendimi i subjektit se nuk ka qenë në dijeni të ekzistencës së prokurës së posaçme të vitit 2008, që autorizon atë të kryejë veprime për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, bie ndesh me transaksionin bankar të kryer prej saj në vitin 2011 [referuar në paragrafin 20.10]. Përpos vetë veprimeve të subjektit për të kryer pagesën, sipas nenit 5, pika 1, germa “d” e ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, bankat kanë qenë të detyruara që transaksionet për llogari të një personi juridik t’i kryejnë mbi bazën e një autorizimi nga i përfaqësuari. Po ashtu, mungesa e dijenisë është jobindëse edhe për shkak të dinamikës së marrëdhënieve të subjektit e personit të lidhur/bashkëshortit me këtë shoqëri, referuar edhe më sipër. Theksojmë që subjekti nuk dha asnjë shpjegim bindës përse kunati jo vetëm hartoi këtë prokurë pa dijeninë e saj, por ky fakt iu bë me dije vetëm kur u njoftua gjatë kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, tetë (8) vite më pas. Nën dritën e lidhjeve të ngushta mes saj e bashkëshortit me vëllanë e tij, si në angazhim aktiv të përbashkët të vëllezërve dhe vetë subjektit në mbarëvajtjen e shoqërisë tregtare “{\*\*\*}” ShPK, apo kontributin e kunatit për nevojat financiare të subjektit dhe bashkëshortit<sup>52</sup>, në të njëjtin moment kohor me prokurën e posaçme, pretendimet e subjektit nuk paraqesin koherencë logjike. Nga ana tjetër, deklarata noteriale e hartuar nga subjekti në shkurt 2016, për efekt të kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja, është pa peshë provuese pasi jo vetëm është

---

<sup>52</sup> Shtjelluar në vijim, huaja prej 2.000.000 lekësh, deklaruar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, si e marrë më datë 14.01.2008 nga kunati.

deklarative, por qartazi, nisur nga rrethanat në të cilat është hartuar, duket minimalisht si derivat i përballjes me një fakt potencialisht dëmtues për situatën e saj si subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003.

**20.13.** Element tjetër që u çmua me rëndësi nga trupi gjykues në drejtim të analizës për interesat privatë të vetë subjektit dhe personit të lidhur në këtë aktivitet tregtar, janë edhe tagrat gjithëpërfshirës me të cilët “i përfaqësuari”/pronari *de jure* autorizon bashkëshortin e subjektit, ndërthurja e vazhdueshme mes fondeve personale dhe atyre të shoqërisë dhe moria e transaksioneve të kryera nga bashkëshorti i subjektit për llogari të likuidimit të detyrimeve të shoqërisë. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti gëzojnë të drejta veprimi në llogarinë e shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK<sup>53</sup> në Tirana Bank, ndërsa nga një shkresë e dytë, rezulton se nga llogaria e “{\*\*\*}” ShPK janë bërë pagesa mujore të *faturave të telefonit* të subjektit, për periudhën 2008-2009<sup>54</sup>. Së fundmi, transaksionet e shumta financiare me destinacion shoqërinë tregtare<sup>55</sup> me të cilën “{\*\*\*}” ShPK kishte marrëveshje bashkëpunimi ndër vite, tregojnë vijimësi përfshirjeje që nuk përkon me një kujdes episodik, të diktuar nga nevoja urgjente apo të tjera rrethana të momentit.

**20.14.** Në këtë kontekst, trupi gjykues vlerëson edhe faktin e rezultuar nga aktet dhe pranuar nga vetë subjekti në seancë dëgjimore për mungesë dakordësie apo sistemi mbi të cilin evidentoheshin të ardhurat personale të bashkëshortit dhe subjektit nga ato të shoqërisë tregtare. Nga aktet në fashikull dhe hetimi, ka rezultuar që bashkëshorti i subjektit ka përdorur të ardhurat pa një dokumentacion ligjor që të evidentojë/gjurmtojë vlerat, sasinë, kohën apo destinimin. Shkresa dërguar Komisionit nga Tirana Bank<sup>56</sup>, së bashku me të dhëna për lëvizjet bankare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në periudhën kohore 2006 – 2017, tregon veprime bankare personale të bashkëshortit të subjektit nëpërmjet llogarisë së shoqërisë. Ky fakt përforcon më tej panoramën e një marrëdhënieje prej pronari dhe joepisodike të bashkëshortit të subjektit.

**20.15.** Së fundmi, dhe lidhur ngushtë me sa është arsyetuar më sipër e në vijim në analizën financiare, ndërthurja e të ardhurave personale me ato të aktivitetit tregtar u vlerësua nga trupi gjykues i Kolegjit në dy plane: si një aspekt që pasqyron natyrën e marrëdhënies si një ortakëri e padeklaruar dhe interes privat i subjektit dhe personit të lidhur dhe në funksion të shkaqeve të ankimit, lidhur me mënyrën e përlllogaritjes dhe efektin e këtyre vlerave në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur. Ndërsa aspekti i parë është arsyetuar në mënyrë shteruese më sipër, në kontekstin e aspektit të dytë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i kryer nga Komisioni për t’ia ngarkuar vlerat monetare analizës financiare të subjektit e personit të lidhur, është i bazuar në kushtet që pretendimet e subjektit që burimi i tyre janë të ardhurat nga aktiviteti tregtar në pronësi të kumatit, mbetën deklarative. Edhe në analizën e kryer në Kolegj mbi bazën e shkaqeve të ankimit, vlerat monetare për të cilat mungon dokumentacion mbështetës apo gjurmë që i lidhin besueshëm dhe qartë me të ardhurat nga shitjet e “{\*\*\*}” ShPK, u përlllogariten në analizën

<sup>53</sup> Shkresat e Tirana Bank nr. {\*\*\*} prot., datë 10.07.2017, dhe shkresa nr. {\*\*\*} prot.

<sup>54</sup> Shkresa e Tirana Bank për Komisionin nr. {\*\*\*}, datë 05.05.2020.

<sup>55</sup> Sipas verifikimit në QKB, shoqëritë “{\*\*\*}” ShPK, “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK janë e njëjta shoqëri, por në momente të ndryshme ka pasur ndryshime të emrit tregtar.

<sup>56</sup> Nr. {\*\*\*} prot., datë 05.05.2020.

financiare si shpenzime të familjes së subjektit, shtjelluar në detaj në rubrikën përkatëse në vijim. Arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit shtjellohet në vijim.

**20.16.** Së pari, nga aktet në fashikull rezulton një marrëveshje shërbimi e datës 1.11.2007, lidhur midis shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK<sup>57</sup>. Edhe duke abstraguar nga problemet e formës, nga përmbajtja rezulton që depozitat në vitin 2015 nga personi i lidhur/bashkëshorti, janë kryer në bankën OTP, ndonëse palët kanë rënë dakord që “{\*\*\*}” ShPK do të depozitojë të ardhurat nga shitja me pakicë në llogarinë në Alpha Bank Gjirokastër të “{\*\*\*}” ShPK, çdo të hënë, të mërkurë dhe të premte. Për më tepër, afati i kësaj marrëveshjeje është sa afati i kontratës së nënqirasë, e konkretisht deri më 31.01.2014. Nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, të ketë paraqitur akte të tjera që do të plotësonin tablonë e marrëdhënies në analizë për të provuar vijimësinë e saj në momentin e depozitimit të shumës prej 4.030.000 lekësh nga bashkëshorti i saj. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit që këto transaksione janë kryer mbi bazën e kësaj marrëveshjeje, gjendet i pambështetur.

**20.17.** Edhe në analizën e gjurmueshmërisë së të ardhurave nga shitja e deri në depozitimin në bankë, trupi gjykues vëren mungesë dokumentacioni mbështetës. Subjekti ka paraqitur në Komision një deklaratë jonoteriale të administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK [z. S. T.], të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, në datën 27.04.2020. Në këtë deklaratë, administratori mbështet pretendimin e subjektit, e konkretisht, që vlerat e depozituara nga bashkëshorti i subjektit janë të ardhura nga shitja e karburantit. Ky deklaram është rikonfirmuar në ankim me një vërtetim tjetër të administratorit të kësaj shoqërie, që mban datën 17.11.2020. Pa përsëritur arsyetimin e mësipërm mbi mosmarrjen e këtij akti nën dritën e nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për shkak të mungesës së të dhënave që do të përbënin risi në proces, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë edhe që ky akt është analizuar gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, ndryshe nga sa pretendon subjekti. Nga përmbajtja e vendimit [faqe 33], konstatohet se Komisioni e ka marrë në shqyrtim deklaratën e thjeshtë të datës 27.04.2020 dhe, pas analizës, ka vlerësuar se subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës për pretendimet mbi mënyrën sesi menaxhoheshin paratë praktikisht nga bashkëshorti përpara depozitimit në bankë, si dhe për të provuar se ato ishin të ardhura të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

**20.18.** Komisioni ka analizuar edhe një akt tjetër të sjellë nga subjekti pas mbylljes së hetimit administrativ<sup>58</sup>, për të plotësuar tablonë e mungesës së dokumentacionit provues – si *kuponë tatimorë apo fatura tatimore të shitjes*, referuar e analizuar edhe më sipër në paragrafin 20.4. Ndonëse ky dokumentacion nuk është pjesë e fashikullit të përcjellë në Kolegj [ndryshe nga sa citon vendimi i Komisionit], trupi gjykues i Kolegjit vëren se situata e mungesës së akteve mbështetëse me vlerë provuese për pretendimet e subjektit, mbetet e pandryshuar. Në kushtet që në thelb nëpërmjet këtij akti paraqiten thjesht lëvizje bankare të një personi juridik të tretë, dhe jo akte që provojnë vlerën e shitjeve, kohën dhe sesi ato rakordojnë me depozitat e bashkëshortit të subjektit, lëvizjet e llogarisë bankare në fjalë nuk paraqesin relevancë për këtë shkak ankimi. Së fundmi, Komisioni ka kryer gjithsesi një analizë të këtyre akteve, nga e cila rezulton se prej tij nuk

<sup>57</sup> Nga verifikimi i së cilës rezulton se ajo nuk është e lidhur rregullisht, pasi nuk mban nënshkrimin e administratorit N. P..

<sup>58</sup> Shih faqen 33 të vendimit të Komisionit, ku referohet se dokumentet shkresore në fjalë, sjellë nga subjekti në datë 02.10.2020, në orën 14:21, nëpërmjet e-mail-it, e konkretisht, një ekstrakt nga statement-i bankar i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, “do t’i vihen në dispozicion Kolegjit”.

mund të arrihet në konkluzion për: (i) burimin e këtyre vlerave; (ii) cilësinë në të cilën ka vepruar personi i lidhur/bashkëshorti; dhe (iii) marrëdhënien që ky i fundit kishte me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, ndërkohë që për shitjet, palët në shkresa kanë parashikuar transfertat bankare për likuidimin e shumave. Për gjithë sa më sipër, pretendimet e subjektit mbetën të pambështetura në akte. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse dhe Komisioni, e përllogariti vlerën në total prej 4.030.000 lekësh, në analizën financiare të pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur.

**20.19.** Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, ka vepruar në cilësinë e drejtueses së institucionit, është gjendur në kushtet e konfliktit rast pas rasti të interesit për vendimmarrjet e saj në cilësinë e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Përmet, për shkak të veprimeve financiare të kryera prej saj në favor të shoqërisë në pronësi të kumatit të saj, cilësuar një lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, nën dritën e germës "ç" të pikës 4 të nenit 3 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar dhe të germës "d" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Parë së bashku me transaksionet bankare të kryera nga personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti, në favor dhe për llogari të personit juridik në fjalë që, ndër të tjera, ka krijuar dyshime të arsyeshme se bashkëshorti i subjektit është ortak i padeklaruar në këtë aktivitet, trupi gjykues i Kolegjit konstaton gjendjen e konfliktit të interesit pasi subjekti krijon marrëdhënie të cilat kanë krijuar premisa për të vjelë përfitime materiale, nëpërmjet personit tjetër të lidhur, kumatit, apo nëpërmjet rolit të spikatur të personit të lidhur/bashkëshortit në këtë veprimtari fitimprurëse, pranuar nga vetë subjekti.

**20.20.** Po ashtu, në kushtet kur të ardhurat e ekonomisë familjare të subjektit dhe personit të lidhur dhe ato të gjeneruara nga aktiviteti privat i “{\*\*\*}” ShPK, rezultojnë të *ndërthurura pazgjidhshmërisht*, trupi gjykues i Kolegjit vendosi t’ia ngarkojë ato shpenzime ekonomisë familjare të subjektit të rivlerësimit, në analizën e viteve përkatëse të subjektit dhe personit të lidhur. Në këtë vlerësim, trupi gjykues thekson se nga të ardhurat personale të subjektit e personit të lidhur kryhen pagesa në shlyerje të detyrimeve të personit juridik në mënyrë të përsëritur, dhe subjekti nuk arriti të provojë sesi të ardhurat nga aktiviteti janë ndarë nga ato personale për të shlyer pagesat në *cash* në bankë.

**20.21.** Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë fshehur interesat privatë të tyre në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK. Konkluzioni i Komisionit për dyshime se personi i lidhur me subjektin/bashkëshorti, është ortak i padeklaruar në këtë aktivitet, është i bazuar. Fakti i përfshirjes së personit të lidhur/bashkëshortit në veprime financiare të këtij subjekti privat dëshmohej qartë nga transaksionet e kryera nga personi i lidhur/bashkëshorti, ndër vite, përfshirë vitin 2008 në Tirana Bank, depozitimet nga “{\*\*\*}” në vitin 2006 në Tirana Bank, por edhe është pohuar vazhdimisht nga subjekti si shpjegim për transaksionet bankare në OTP në vitin 2015, në vlerën 4.030.000 lekë, brenda harkut kohor korrik-tetor. Së fundmi, ky fakt përforcohet nga prokurat e lëshuara në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortit për të vepruar në emër e për llogari të kësaj shoqërie, sikurse edhe nga transaksioni i kryer nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, në vitin 2011, nëpërmjet llogarisë së saj në Raiffeisen Bank. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa "c" e ligjit nr. 84.2016.

## 21. Analiza financiare e viteve 2003-2016

21.1. Si referuar edhe më sipër, në përfundim të procesit të hetimit, Komisioni ka konstatuar një mungesë burimesh për periudhën e rivlerësimit, në vlerën (-) 11.592.775 lekë, pasi ka marrë në konsideratë disa nga shpjegimet e subjektit. Përpos sa është shtjelluar më sipër, në këtë balancë negative Komisioni ka mbajtur në konsideratë edhe disa zëra shpenzimesh të tjera, të rezultuara nga hetimi administrativ, e konkretisht: (i) një pagesë të bashkëshortit në vlerën prej 200.000 lekësh, kryer në vitin 2007; (ii) dy vlera financiare të deklaruara në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012 si kthim borxhi bashkëshortit nga dy individë, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se pretendimet e subjektit nuk u provuan; (iii) një transfertë bankare në vlerën 41 mijë USD, kryer në janar 2008, për të mbuluar shpenzimet për një ndërhyrje kirurgjikale për vajzën e subjektit në vitin 2008; dhe së fundmi (iv) tri llogaritë bankare të bashkëshortit në Tirana Bank (në lekë, euro e dollarë), çelur në vitin 2006 e mbyllur në vitin 2014. Llogaria në të njëjtën bankë në lekë, është analizuar më sipër në kuadër të marrëdhënies së interesit me “{\*\*\*}” ShPK [shih ndër të tjerë paragrafin 20.5].

21.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton rezultatin e analizës financiare të Komisionit. Ajo potencon se shpenzimet e kryera janë rritur fiktivisht për vitet përkatëse, nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, pretendon se ka qenë vlerësim i gabuar mospërfshirja në analizën financiare të të ardhurave e huave të kthyera bashkëshortit nga dy individë, sikurse edhe të ardhurave nga lotoja sportive në vitin 2011. Subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, pretendon se gjendet në kushtet e mundësisë financiare për vitet e rezultuara me balancë negative sipas vendimit të Komisionit, dhe ka kërkuar që analiza financiare të pasqyrojë shpjegimet e dhëna prej saj, si vijojnë.

(i) *Pagesa e vlerës 200.000 lekë për llogari të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2007, është kryer për të arritur planin tatimor për shlyerjen e detyrimit të kësaj shoqërie për muajin qershor 2007 dhe është kryer nga bashkëshorti në cilësinë e inspektorit tatimor. Shuma është kthyer dorazi nga shoqëria. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar një deklaratë të administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.*

(ii) *Transferta e vlerës 41.650 USD ka pasur për qëllim shpenzimet për ndërhyrjen kirurgjikale të vajzës. Kjo vlerë nuk duhet të përfshihet në analizën e saj financiare pasi rrit fiktivisht shpenzimet e vitit 2007, ndërsa ka për burim huanë 2.000.000 lekë nga kunati [z. N. P.] dhe 25.000 euro nga një i afërm i bashkëshortit. Si të tilla, këto fonde nuk janë dhënë kundrejt krijimit të pasurisë.*

(iii) *Shumat e kthyera nga dy huamarrës<sup>59</sup>, përkatësisht 300.000 lekë dhe 550.000 lekë, duhet të përfshihen si të ardhura të ligjshme për vitin 2012-2013, pasi janë kthyer nëpërmjet sistemit bankar.*

(iv) *Fitimet e bashkëshortit nga lotaria sportive në vlerën 600.000 lekë, duhet të përfshihen në analizën e të ardhurave të ligjshme të vitit 2011.*

21.3. Trupi gjykues i Kolegjit, mbi bazën e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, vëren se pretendimet e subjektit janë të pabazuara, ndërsa vendimi i Komisionit është i mbështetur në ligj e në prova. Edhe pas kontrollit të kryer në Kolegj, konfirmohet situata e analizës financiare me mungesë burimesh. Trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson jobindëse shpjegimet e subjektit për secilin nga zërat e të ardhurave e shpenzimeve të kryera që janë objekt i kësaj pjese

<sup>59</sup> Referuar si z. G. Ll. dhe z. E. M..



të analizës, pasi janë deklarative apo të paprovuara me akte të kohës. Në vijim të këtij arsytimi dhe të nevojës për të mos përkeqësuar situatën financiare të rezultuar pas vendimit të Komisionit, në analizën e kryer në Kolegj, vlerat financiare janë përfshirë sipas analizës së Komisionit. Në vijim, arsytimi i Kolegjit për secilin nga aspektet e parashtruara nga subjekti në funksion të analizës financiare.

**21.4.** Nga hetimi administrativ<sup>60</sup>, Komisioni ka konstatuar *një pagesë* prej 200.000 lekësh, të kryer nga bashkëshorti i subjektit, në datën 26.06.2007, në bankë [Tirana Bank], me përshkrimin “pagesë tatim fitimi për muajin qershor nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK”. Subjekti është shprehur se pagesa ishte kryer për llogari të administratorit të këtij personi juridik, meqenëse bashkëshorti ishte punonjës i administratës tatimore dhe kishte nevojë të realizonte planin tatimor të muajit. Në përfundim të procesit, Komisioni e ka konsideruar këtë shumë si shpenzim të subjektit dhe personit të lidhur për vitin përkatës, për shkak se nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës.

**21.5.** Komisioni nuk është ndalur shprehimisht e në detaj në arsyet përse deklarata e administratorit nuk ka vlerë provuese, por ka konkluduar në mënyrë të përmbledhur që pretendimet e subjektit nuk u provuan me dokumentacion, siç rezulton nga faqja 43 e vendimit. Me fjalë të tjera, ndonëse mungon një shpjegim i dedikuar, Komisioni duket se nënkupton që deklarata [sikurse edhe nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit] nuk përbën dokumentacion shkresor “në kohë reale” për të provuar pretendimet e subjektit. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson që Komisioni e ka marrë në konsideratë deklaratën, duke mos i dhënë asaj vlerë provuese.

**21.6.** Sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit qoftë për arsyen e kryerjes së këtij transaksioni apo për kthimin e fondeve dorazi, nuk u provuan me dokumentacion shkresor. Deklarata e thjeshtë *pa datë* e një individi që referohet si administratori i shoqërisë, i cili konfirmon sa pretendon subjekti<sup>61</sup>, paraqitur gjatë hetimit administrativ, paraqet peshë të reduktuar provuese pasi mbetet deklarative dhe e njëanshme, dhe nuk arrin të shpjegojë apo të mbështesë në dokumentacion qoftë edhe rrethanor arsyet për dinamikën e pretenduar të veprimeve të përshkruara. Nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit, nga e cila konfirmohet pagesa objekt analize, po ashtu nuk ka asnjë vlerë provuese në kushtet që nuk hedh dritë mbi sa pretendohet, apo për sa i përket kthimit të kësaj vlere. Përpos këtij konstatimi, trupi gjykues e vlerëson të pakuptimtë dinamikën e veprimeve që prezantohen apo arsyet për të cilat një punonjës i administratës tatimore zgjedh të paguajë nga të ardhurat personale një detyrim që i përket një subjekti tatimor, qoftë edhe për shkak të planit të të ardhurave të muajit në favor të buxhetit të shtetit. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se qëndrimi i Komisionit për ta përllogaritur vlerën 200.000 lekë si shpenzim të subjektit dhe personit të lidhur, është i bazuar.

**21.7.** Gjatë hetimit administrativ – si pjesë e akteve dhe analizës së llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit në Tirana Bank, shtjelluar gjerësisht edhe në paragrafin 20.5 e vijim, ndër të tjerë – Komisioni konstatoi që personi i lidhur/bashkëshorti ka transferuar nëpërmjet bankës shumë 41.650 USD, më 14.01.2008, si derivat i gjendjeve të llogarive të tij në euro dhe në lekë, në vlerat përkatëse. Shuma e transferuar nga bashkëshorti i subjektit ka për burim *tri*

---

<sup>60</sup> Shkresë dërguar Komisionit nga Tirana Bank më 27.12.2019, referuar në poshtëshënimin nr. 36 të vendimit.

<sup>61</sup> Deklaruesi shprehet se: “[...] vërtetoj se në muajin qershor të vitit 2007, datë 29, shtetasit A. P. ka paguar nga llogaria tij, nëpërmjet Tirana Bank, derdhjen e kështit tatimor në shumën 200.000 lekë për llogari të firmës “{\*\*\*}”, për pamundësi objektive të derdhjes nga ana ime të kësaj shume, shumë e cila i është dhënë dorazi shtetasit A. P. ”.

derdhje në *cash* në qershor, tetor dhe dhjetor 2007, në llogaritë e tij në euro dhe lekë në të njëjtën bankë. Transferta është kryer në favor të një individi në ShBA, që ka rezultuar të jetë motra e subjektit. Nga hetimi, Komisioni ka konstatuar se shuma është kthyer më 22.04.2008. Subjekti ka sjellë dokumentacion [gjatë hetimit administrativ], nga i cili konfirmohet që vajza e subjektit i është nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale në ShBA në shkurt 2008, për mundësimin e së cilës u krye transfera. Sipas subjektit, shumat e depozituara nga bashkëshorti kanë pasur për burim *dy hua*, të padeklaruara më parë, përkatësisht nga kunati [z. N. P.] dhe një i afërm tjetër i bashkëshortit [z. K. Gj.], përkatësisht në vlerat 2.000.000 lekë dhe 25.000 euro.

**21.8.** Përfundimisht, Komisioni ka konstatuar se asnjë prej huadhënësve nuk ka konfirmuar huatë dhe nuk ka burime të ligjshme të mjaftueshme nga aktivitetet private. Në përfundim, ky aspekt i vlerësimit është përfshirë te konkluzioni përmbledhës për fshehje të pasurisë dhe mungesës së burimeve në vlerën (-) 3.552.843 lekë në vitin 2007, sipas germave “c” dhe “b” të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për sa u përket shpenzimeve shëndetësore për vajzën në vitin 2008, pasi ka administruar në cilësinë e provës pesë (5) akte<sup>62</sup> të sjella nga subjekti në cilësinë e provës, ndonëse disa jo në formën e kërkuar nga ligji, Komisioni ka konkluduar nga dokumentacioni që shpenzimet janë mbuluar nga të tretë e, për pasojë, nuk i ka përfshirë shpenzimet mjekësore në analizën financiare të vitit 2008. Sipas Komisionit, balanca financiare për vitin 2008, mbetet gjithsesi pozitive.

**21.9.** Në ankim, subjekti pretendon se shuma e konstatuar e pambuluar me burime të ligjshme, nuk duhet të përllogaritet si shpenzim në vitin 2007, për shkak të qëllimit për të cilin thekson se është kryer transfera – ndërhyrjes kirurgjikale të kryer në vitin 2008. Subjekti po ashtu pretendon se huadhënësit kanë burime të ligjshme, e konkretisht, të ardhurat e kunatit nga emigracioni, përpos fitimeve nga aktiviteti privat i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shitjet momentale të karburantit. Për sa i përket huadhënësit tjetër, po ashtu i afërm i bashkëshortit, z. K. Gj., subjekti kërkon të përllogaritet sa rezulton nga të ardhurat e xhiros për vitet 2006-2008 dhe bilanci i vitit 2008 për aktivitetin privat, pronë e tij [“{\*\*\*}” ShPK, po ashtu i përfshirë në tregti karburantesh].

**21.10.** Trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi të bazuara konkluzionet e Komisionit, duke ndjekur e duke iu bashkuar së njëjtës linjë arsyetimi, përmbledhur më sipër. Pa përsëritur sa ka konkluduar Komisioni, trupi gjykues çmon të theksojë një sërë aspektesh nga të cilat rezulton që pretendimet e subjektit për huanë nga dy familjarë/të afërm të bashkëshortit nuk u provuan as për nga ekzistenca, dhe as për nga mjaftueshmëria e burimeve të ligjshme të nevojshme për të krijuar tri depozitat në *cash* që kanë shërbyer për krijimin e fondeve në vlerën 41.650 USD. Konkretisht, vlera 20.000 euro në llogarinë e bashkëshortit, rezulton derivat i dy depozitimeve në vlerat 6.000 dhe 19.000 euro, përkatësisht në qershor dhe dhjetor 2007. Pjesa tjetër e vlerës përbëhet nga maturimi i një depozite prej 1.000.000 lekësh, krijuar nga disa depozita në *cash* përgjatë vitit 2007 nga bashkëshorti. Në asnjë prej këtyre transaksioneve nuk ka referencë në burimin e krijimit – pretenduar të jenë huatë. Asnjë prej vlerave nuk përkon me vlerën e huave. Subjekti nuk i ka deklaruar huatë asnjëherë derisa u pyet nga Komisioni në pyetësorë, sikurse nuk ka specifikuar kohën kur ato janë dhënë apo provuar marrjen e huave nga huadhënësit. Nuk ka asnjë indicie, qoftë edhe të largët, që të mundësonte gjurmueshmërinë e të ardhurave nga huadhënësit të bashkëshortit. Të tilla do të ishin akte që provojnë tërheqje vlerash në momente dhe shuma që përkojnë edhe pjesërisht me *cash*-in e depozituar, shënime në bilancet e dy shoqërive tregtare për tërheqjet,

<sup>62</sup> Referuar në faqen 50 të vendimit të Komisionit.

deklarata të kohës nga huadhënësit apo subjekti e bashkëshorti. Së fundmi, subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar të ardhurat e pretenduara të kunatit nga emigracioni, që janë deklaruar si burim për huanë.

**21.11.** Nga aktet e sjella nga subjekti për të provuar mundësinë e dhënies hua nga aktiviteti privat i dy shoqërive tregtare<sup>63</sup>, ka rezultuar që “{\*\*\*}” ShPK ka pasur për dy vite, në total fitim prej 1.000.000 lekësh, duke rezultuar e pamundur huadhënia prej z. N. P. në vlerën 2.000.000 lekë në vitin 2007 nga ky aktivitet. Për sa i përket mundësisë së huadhënësit tjetër për të dhënë 25.000 euro, nga aktet ka rezultuar se fitimet e krijuara kanë mbetur të pashpërndara nga shoqëria deri në vitin 2008.

**21.12.** Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit për të përfshirë e ngarkuar në analizën financiare të vitit 2007, depozitimet e *cash-it* nga bashkëshorti, gjendet i bazuar. Përpos sa është konkluduar edhe më sipër për fshehje të interesave financiarë të subjektit dhe personit të lidhur në “{\*\*\*}” ShPK, subjekti gjendet edhe në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**21.13.** Gjatë hetimit administrativ, duke marrë shkas nga deklaratat periodike vjetore të subjektit për vitet 2012 dhe 2013 për kthim huash, përkatësisht në vlerat 850.000 lekë dhe 3.496 USD, Komisioni, pasi ka analizuar përgjigjet e subjektit në pyetësorë, ka konkluduar që t’ia ngarkojë ekonomisë familjare të subjektit e personit të lidhur këto dy shuma. Përfundimisht, Komisioni i ka konsideruar deklaratimet e subjektit të pasakta e të pamjaftueshme për deklaratat periodike vjetore. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka vërtetuar me dokument shkresor në kohë reale dhënien e huave në fjalë dhe në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar asnjë vlerë likuiditeti në lekë si huadhënie dhe asnjë detyrim financiar për shkak të saj, sipas parashikimit të germës “d” të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, që nga viti 2003. Ndërsa këto dy vite dalin me balancë pozitive në analizën e Komisionit, konkluzioni për këto dy deklarime lidhet me analizën për periudhën kohore përpara vitit 2003, duke ndikuar negativisht në analizën për mundësinë e krijimit të depozitës bankare origjinare në Raiffeisen Bank, në vlerën 2.000.000 lekë, shtjelluar gjerësisht në paragrafin 18 dhe referuar edhe në 18.8.

**21.14.** Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani, këto hua – përkatësisht prej 850.000 lekësh dhe 3.496.28 USD – të kthyer bashkëshortit, kanë burim të ardhurat e tij përpara vitit 2003 nga punësimi dhe emigracioni. Në ankim, subjekti pretendon se borxhet nuk janë deklaruar në vitin 2003, për shkak se janë konsideruar të pakthyer në kohën kur janë krijuar si detyrim [i të tretëve], e lidhen me të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i saj gjatë periudhës që ka qenë emigrant në Greqi. Subjekti kërkon që këto fonde të deklaruara të kthyer<sup>64</sup> në DVP 2012 e 2013, të përfshihen si të ardhura të ligjshme për vitet 2012-2013, meqenëse kthimi i tyre është konfirmuar nëpërmjet sistemit bankar.

---

<sup>63</sup> Deklaratat tatimore të “{\*\*\*}” ShPK për vitet 2006-2007, shkresë nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor për qarkullimin e fitimit e kësaj shoqërie dhe pasqyrat financiare të vitit 2008 dhe formularin e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimit për “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>64</sup> Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “[...] depozitim në llogarinë personale të bashkëshortit, si kthim i borxhit të vjetër të padeklaruar, në shumën 850.000 lekë”, e depozituar nga znj. M. Th., më datë 07.08.2012, në vlerën 300.000 lekë dhe më datë 31.08.2012, shumën 550.000 lekë. E njëjta situatë paraqitet edhe me borxhin e deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 nga bashkëshorti i subjektit nën shënimin: “borxh i vjetër i padeklaruar, derdhur në llogarinë bankare në Tirana Bank, shuma 3.496,28 USD”.

**21.15.** Nga verifikimi i dokumentacionit në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se është i drejtë konkluzioni i Komisionit për të mos përlllogaritur në të ardhurat e viteve përkatëse, shumat e dërguara në llogarinë e bashkëshortit të subjektit. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mban në konsideratë faktin që pretendimet e subjektit për këto hua, janë deklarative, ndërsa fakti që fondet janë depozituar në llogari bankare, nuk tregon asnjë të dhënë për ligjshmërinë e burimit të tyre, apo që pretendimet për rrethanat që kanë sjellë depozitim në vitet 2012 dhe 2013, janë të bazuara. Po ashtu, trupi gjykues vëren se asnjë ndër dy huatë e pretenduara nuk është pasqyruar e materializuar në një dokument në të cilin këta dy individë konfirmojnë sa pretendon subjekti.

**21.16.** Konkretisht, nga aktet në fashikull, kanë rezultuar disa transaksione hyrëse në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit, në Raiffeisen dhe në Tirana Bank. Dy të parat, përkatësisht më 08.09.2012 dhe 31.08.2012, në total në vlerën prej 850.000 lekësh, janë kryer prej një individi që subjekti e referon si motra e një prej huadhënësve, z. Ll.. Transaksioni tjetër, kryer më 11.11.2013, është në vlerën 5.000 USD dhe me përshkrimin “likuidim detyrimi” nga dërguesi [z. E. M.]. Për huanë e parë, subjekti është shprehur se është dhënë në vitin 1995 në dhrahmi greke një shoku të bashkëshortit. Tjetri në vlerën 400.000 lekë, dhënë “përpara vitit 2004” shokut të ngushtë të bashkëshortit, sipas subjektit. Gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti ka dorëzuar një deklaratë noteriale të motrës së huamarrësit [znj. M. Th.], e cila ka kryer transfertat e vitit 2012, që mban datën 11.05.2020, nëpërmjet së cilës konfirmohet versioni i fakteve të pretenduara nga subjekti. Për huanë tjetër, [nga z. E. M.], subjekti nuk ka dorëzuar asnjë dokument.

**21.17.** Nga sa më sipër, rezultojnë disa konkluzione që konfirmojnë qëndrimin e Komisionit. Së pari, huatë nuk janë materializuar e provuar nga vetë huadhënësit në kohën reale. Deklarata noteriale e motrës së njërit prej tyre, hartuar gjatë hetimit administrativ, thjesht konfirmon pretendimet e subjektit, pa përcjellë ndonjë fakt në dobi të provueshmërisë së sa pretendohet. Trupi gjykues vëren se mungon dokumentacion apo indicie që të vërtetojë këtë marrëdhënie në momentin e krijimit të saj në çfarëdo forme, deklaratë njohje detyrimi, kontratë huaje, deklaratë borxhi etj. Në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të kohës që të vërtetojë ose provojë dhënien hua, sikurse as referuar këto hua në ndonjë formë në deklaratat periodike vjetore të periudhës kohore deri në depozitim e dy shumave, mungon çdo indicie e marrëdhënies së huas. Së fundmi, në kushtet që nuk ka asnjë dokumentacion që të provojë të ardhura të bashkëshortit nga emigracioni në Greqi, përjashtohet edhe teorikisht ekzistenca e tyre, përpos ligjshmërisë. Së fundmi, në një analizë hipotetike që do të pranohej ekzistenca e këtyre të ardhurave dhe dhënies së huas, do të përmysej rezultati pozitiv i analizës financiare të subjektit dhe personit të lidhur për pasuritë e krijuara përpara vitit 2003 [depozita në ish-Bankën e Kursimeve, sipër referuar] në kushtet që nuk ka asnjë akt të sjellë gjatë hetimit administrativ që do të provonte të ardhura të bashkëshortit. Edhe vetë subjekti nuk ka deklaruar të ardhura të tij në deklaratën përpara fillimit të detyrës. Nga ana tjetër, transferimi i vlerës nëpërmjet bankës nuk provon asgjë përpos fakteve të sipër-konstatuara: datës, vlerës së transferuar, identitetit të dërguesit dhe përfituesit si dhe ekzistencën e tyre në momentin kur është kryer transaksioni. Qartazi, burimet dhe marrëdhënia që qëndron në bazë të transfertës nuk mund të provohen vetëm për shkak të dërgesës nëpërmjet bankës.

**21.18.** Së fundmi, pas verifikimit të elementeve të mësipërme në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit, Kolegji konfirmoi vitet 2006, 2007, 2009, 2010, 2011 dhe 2015, me balancë negative në të njëjtën linjë me Komisionin. Në këtë vlerësim, përpos gjithë sa shtjelluar në detaj

më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë mospërfshirjen e fondeve me vlerë 600.000 lekë në të ardhurat e vitit 2011, të deklaruara të përfituara nga *paga dhe lotaria sportive* e bashkëshortit. Mungesa e dokumentacionit për të saktësuar vlerën e përfituar prej pagës dhe prej lotarisë sportive, është pranuar edhe nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>65</sup>. Në vijim të kontrollit të analizës financiare të kryer nga Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit konkludon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe për të përballuar shpenzimet e jetesës, për vitet me balancë negative.

22. Përfundimisht, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit në ankim dhe në parashtrime, shqyrtoi provat shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të kësaj çështjeje, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Silvana Pani, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Nën dritën e pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë.
23. Për sa më lart, vendimi nr. 303, datë 05.10.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 303, datë 05.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Silvana Pani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 11.07.2023.

**ANËTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

---

<sup>65</sup> Në përgjigje të pyetësorit 2, subjekti sqaroi se: “Shuma e përfituar nga bashkëshorti im nga lotaria sportive për vitin 2011, nuk mund të saktësohet për shkak të mungesës së dokumentacionit dhe kohës relativisht të gjatë që ka kaluar. Dokumentacioni i lotarisë sportive nuk ekziston pasi dorëzohej skedina”.